

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 29 Shkurt2024

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 32

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 32

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 1

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të nderuar këshilltarë fillojmë mbledhjen e rradhës të këshillit bashkiak meqënëse kourumi është i aritshëm e fillojmë këtë mbledhje. Së pari do të kërkoja dakortësimin tuaj në lidhje me rendin e ditës dhe do ju lutesha këshilltarëve të hapin mikrofonin kur marin fjalën në mënyrë që të rregjistrohen sepse duke qënë mikrofonin i mbyllur nuk dëgjohet dhe nuk zbardhen fjalët në procesverbalin e mbledhjeve.

Këshilltar E.Bregu: Faleminderit, pikë së pari doja të ngrija problemin në lidhje me monitorimin me kamera dhe audios sepse ka shumë ankesa që nuk dëgjohet zëri dhe pjesa tjetër e rëndësishme është që pamja filmike vjen gjithmonë nga mbrapa dhe nuk ka një kamera përpara. Nuk e di nëse është e mundur të vendoset kamera apo ekziston dhe nuk funksionon?

Së dyti në mbledhjen e rradhës së muajit të kaluar në 25 janar mbledhja e këshillit u mbyll dy herë para kohe në shkelje të rëndë të procedurave, ndaj doja të sillja në vëmendje që këto gjëra nuk duhet të ndodhin për shkak se mënyra sesi po trajtohet këshilli po sjell mungesën e interesit të këshilltarëve për të marrë pjesë në mbledhje dhe po detyrohen drejtuesit e këshillit që ti marin në telefon këshilltarët dhe tju luten që aman hajdeni merni pjesë sepse nuk bëhet kourum, gjithashtu i sjell në vëmendje kryetarin të grupit të këshilltarëve socialistë Petrikës i cili në mbledhjen e dhjetorit kishte merak se këshilltarët e opozitës po i prishnin mbledhjen po i them që ata që po e prishin mbledhjen janë këtu në mesin tuaj duke e mbyllur mbledhjen para kohe i keni në mesin tuaj ndoshta dhe më lart se mesi juaj, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për sygjerimin do i marrim në konsideratë por do doja që dhe ju të jeni më korektë në zbatimin e rregullores së këshillit sepse është e dyanshme nuk ka vetëm një palë, faleminderit dhe një herë.

Këshilltar E.Bregu: Kam diçka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem tani sepse nuk mund të bëjmë debat që në fillim në lidhje me këtë pjesë, ju shprehët menimin tuaj unë timin.

Këshilltar E.Bregu: Po pra por meqënëse me tërhoqët vëmendjen unë jam i detyruar të përgjigjem, do të lutesha që në rast se ke ndonjë çështje konkrete ose nëse nuk ke kur ta kesh mu drejto, mos u drejto në përgjithësi sepse dukesh jo korrekte.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ok faleminderit, atëhere në lidhje me rendin e ditës kush është dakort dhe nëse ka diçka para se të miratojmë rendin e ditës?

Këshilltar D.Osmani: Faleminderit e nderuar kryetare, atëherë në lidhje me rendin e ditës për sa i përket një pike të saj që ka të bëjë me miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë Korçë i cili presupozohet të ketë dhe setin e dokumentave bashkëngjitur nga materialet që i janë dhënë në dispozicion këshillit qoftë me email qoftë dhe materiali i printuar është i paplotë dhe po ju marr një shembull të cilin ju mund ta shihni dhe ta konstatooni dhe vet për sa i përket në kreu 1 ndryshimet në tabelën e treguesve këtu tek kjo harta treguese janë vetëm tre ndryshime në një kohë që ka 6 ndryshime. Tjetër për sa i përket po kësaj pike kreu 2 unë nuk shikoj as tek materiali as në email nuk ishte as kreu 3 harta ilustruese e njësisve besoj 24 faqe duhet të jetë kjo as kjo nuk ishte bashkëngjitur materialit, duke qënë para faktit që ky material është i paplotë dhe ne jemi të papërgatitur pasi nuk mund të analizonim ndryshimet i kërkoj këshillit që ta shtyjë për një afat të dytë këtë pike të rendit të ditës duke plotësuar dokumentat dhe më pas vazhdojmë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në këndvështrimin tim të paktën tek materiali që unë kam nuk e di çfarë keni ju është i plotë megjithatë para se të sqarohemi edhe për këtë pjesë fjalën e ka kryetari.

Këshilltar E.Nexhipi: Tre janë ato që ndryshojnë, 6 mund të jenë emërtesat që janë në kufi njëra me tjetrën nuk ka 6 ndryshime 3 ndryshime janë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës tre janë ndryshime në planin rregullues të cilat po i futim jashtë listës të ndryshimeve të tjera që ne mendojmë tju propozojmë për këtë plan në një moment të dytë, bëhet fjalë për një ndryshim që lidhet me vend depozitimin e mbetjeve inerte të bashkisë Korçë, një ndryshim tjetër që lidhet me sipërfaqen e varrezave të fshatit Drenovë dhe një ndryshim i cili lidhet me kërkesën e një biznesi bëhet fjalë për fabrikën e oxhaqeve i cili është një biznes shumë i rëndësishëm në qytetin e Korçës i cili kërkon të shtojë kapacitetin të rite numrin e investimit që ka bërë, të rritë numrin e punojësve por që të realizohet synimi i këtij biznesi kërkohet ndryshimi i planit rregullues si sipërfaqe ngjitur me ndërtesën ekzistuese ku ai kërkon të zgjerojë aktivitetin, në planin rregullues është planifikuar tokë buqësore pra kërkohet ndryshimi i kësaj sipërfaqe nga toke buqësore në zone të zhvillimit të industrial dhe ekonomik. Këto janë tre ndryshime të planit rregullues, tani në rast se keni nevojë për të mos i zgjatur sepse janë çështje që i kemi me një lloj urgjence të themi, në rast se keni nevojë drejtoresha e urbanistikës është këtu mund tju sqarojë, komisioni që presupozohet ta ketë shqyrtuar dhe të ketë marrë informacion më në detaje për këtë çështje është mbledhur por këto janë tre pikat për të mos e vonuar procesin mendoj që ta sqarojmë me diskutim këtu edhe me sqarim nga drejtoresha e urbanistikës, është bërë dhe konsultimi publik nuk e di ka marrë pjesë dikush nga ju apo jo, këto janë ndryshimet e propozuara.

Këshilltar D.Osamin: Jam shumë dakort me pjesën e justifikimit por problemi është që komisioni mund të ketë marrë informacion por jo të gjithë këshilltarët janë tek ky komision, e dyta ai material që ju na shpjeguat shumë mire mund të ishte dhe i bashkëngjitur që dhe ne të jemi të informuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këtë material mbase e sqaron drejtoresha?

Këshilltar D.Osamin: Komplet kjo që thatë ju nuk ishte.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po është i bashkëngjitur por mos ka ndonjë detaj që nuk e keni të qartë dhe të sqarohet?

Këshilltar A.Habip: Më fal Devis në komision kur janë shqyrtuar ishin dhe materialet.

Këshilltar D.Osamin: Ti në komision je?

Këshilltar A.Habip: Jam sekretar i komisionit.

Këshilltar D.Osamin: Ju lutem kryetare është e disata herë në mbledhjet e këtij këshilli që përgjigjen këshilltarët për problematikat nuk jam këtu për të dëgjuar këshilltarët me shumë respekt për të gjithë, jemi këtu për të dëgjuar ekzekutivin dhe mbledhjen e drejtuar nga ju.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për ekzekutivin meqënëse Devi e ngriti këtë çështje në lidhje me materialin që keni shpërndarë.

Drejtoresha e Urbanistikës Zhaneta Lubonja: Materiali është i plotë me gjithë dokumentacionin bashkëngjitur ka harta dhe prandaj i kemi shumëfishuar me ngjyra që të jenë të kuptueshme dhe çdo material e ka hartën dhe materialin sipas ligjit që kërkohet për tu dërguar në Tiranë.

Këshilltar D.Osamin: Tek kreu 1 ndryshimet në sipërfaqet e njësisë strukturore dhe thotë pika 1 në pasaportën e njësisë strukturore dr/b21 ok është, pika 4 dr/ub 30 është dhe pika e tretë është dr/b40, po të pyes në dr/b21 ku është harta?

Drejtoresha e Urbanistikës Zhaneta Lubonja: Në b21 është ky konfiguracioni lejla.

Këshilltar D.Osamin: Kordinatat e njësisë jepen në kreu 2, ku është kreu 2?

Po të pyes për pikën 4 dr/ub30?

Drejtoresha e Urbanistikës Zhaneta Lubonja: Në të njëjtë hartë treshi konfiguracioni me lejla është në njësia strukturore që po diskutoni dhe nga kjo hiqet një cope shumë e vogël që i bashkohet industrisë të ekonomisë sepse kjo njësi strukturore është ub.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal mund të them diçka kryetare?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani me shumë respekt për këshillin, ky diskutimi që po doni të bëni është shumë teknik prandaj janë dhe komisionet prandaj dhe çdo këshilltar mund të shkojë dhe të marrë informacion tek drejtorja e urbanistikës në rast se ka ndonjë gjë për materialin sepse nuk e kemi kufizuar informacionin, për mua bëheni këtë diskutim por në rast se do i hyni tani hartës ta shikoni me kordinata shikojeni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dhe diçka tjetër në lidhje me rendin e ditës ka erdhur një material shtesë në lidhje me pikën 8 të rendit të ditës nga Qendra e Artit dhe Kulturës që ka të bëjë me taksat dhe tarifatat vendore ku propozohet për të përcaktuar biletën e hyrjes për në galerinë “Guri Madhi”. Një propozim e bëri Z.Osamni për të mos e futur këtë pikë në rendin e ditës unë po shtoj këtë pikë të rendit të ditës për pikën 8 dhe nëqoftëse ka diçka tjetër në lidhje me rendin e ditës nga këshilltarët ju lutem kush e do fjalën ?

Këshilltar I.Bode: Përshëndetje të gjithëve, për tu rikthyer tek rishikimi i planit të përgjithshëm vendor në fillim të materialit kemi një kërkesë bazuar në ligjet dhe pikat që ndodhen këtu dhe thotë kërkon për miratimin e planit të përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar dhe setin e dokumentave bashkëngjitur po mbi atë është hartuar edhe projektvendimi apo jo, të miratojmë rishikimin e planit vendor mbrapa kësaj është përsëri kërkesa apo ajo që do i cohet KKt-së dhe

kemi materialin bashkëngjitur sepse këtu është puna, përmbajta kreu 1 që ka titullin e vet, kreu 2 që këtu nuk është dhe kreu 3 që këtu përsëri nuk është, për sa i përket ndryshimeve të paraqitura po mund të jetë që zvogëlimi i një parcele kërkon shtimin e një parcele tjetër që mund të jenë kufi dhe kështu por në të gjitha këto ndryshimet thotë koridnatat e njësisve jepen në kreu 2 dhe kreu 2 këtu nuk ka dhe diçka tjetër ky material që ne kemi këtu në zarf nuk është fare ai material që ne kemi marrë me email, pra në email mungojnë edhe disa fletë të tjera dhe na paraqitet vetëm harta me ndryshimet e propozuara, kështu që nuk e di si mund të gjykojmë mbi bazë mungesë dokumentash mund të jetë teknike po mbase mund ta ketë parashtruar dhe komisioni por nuk është ndonjë gjë që dhe komisioni të ketë berë gabim, e ka kaluar pa e kuptuar mire këtë gjë sepse për sa kohë mungojnë dokumentat bashkëngjitur që ne duhet të miratojmë projektvendimin sipas tyre janë të paplota duhet të ishin 24 fletë kam përshtypjen sipas numrit rendor të paraqitur në përmbajtje, ndërkohë që janë vetëm 5.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëqoftëse nuk ka diçka tjetër fjala për këshilltarin Erjon Nexhipi.

Këshilltar E.Nexhipi: E mar fjalën në emër të komisionit, ne si komision u mblodhëm dhe diskutimi kryesor ishte në lidhje me pronësinë e kësaj pjesës që u kërkua ndryshimi sepse pjesën teknike sa metra me këtej sa metra më andej nuk besoj se vllente si diskutim. Të treja këto sipërfaqe që kërkojnë ndryshim destinacioni janë mire të përcaktuara qoftë vendodhja qoftë dhe destinacioni për se po kërkohen pjesën e dokumentave teknike që e shoqërojnë këtë për të detajuar me kordinata apo me dokumentacion pronësie i detajuar nuk më duket sepse sado ta verifikojmë ne e zgjidhim nuk është pjesë që na takon ne ta shikojmë me kaq shumë detaje sepse do kthehemi më pas në kadastër apo diçka më shumë këshilli teknik i këshillit kombëtar të rregullimit të teritorit , për mua tre sipërfaqet e propozuara për ndryshim destinacioni plotësonin kriteret ligjore janë ndjekur hapat e nevojshëm qoftë me konsultimin publik, qoftë me diskutimin teknik apo qoftë me grupet e interesit po flasim për shtesë varrezash në Drenovë , po flasim për fushën e mbetjeve inerte në një vend ku aktualisht është i braktisur e lënë pasdore po synojmë të zgjidhim shqetësimin e mbetjeve inerte dhe e treta që është një nga investimet më serioze që ka pasur në drejtim të punësimit por edhe zhvillimit të biznesit më kontekstin e eksportit. U diskutuan në komision dhe u konsideruan si shumë të drejta dhe kaluan për miratim, diskutimi teknik tani është vendosur kordinata apo jo unë nuk jam në gjendje ta lexoj dhe sikur të ishte në material bashkëngjitur kordinata, pjesën grafike po jam në gjendje ta lexoj dhe nuk kishte dyshime për ndonjë element të fshehur. Nuk e di ka ndonjë gjë më teknike që mund të shpjegosh Zhani?

Drejtoresha e Urbanistikës Zhaneta Lubonja: Kordinatat janë i kemi që ti dërgojmë në Tiranë sepse ata janë organi teknik dhe i kontrollojnë koridnatat dhe na u duk e panevojshme që ti paraqisnim por jo se nuk i kemi ne e kemi materialin e plotë, kordinatat janë kordinatat e çdo pike dhe sidomos tek fusha e vend depozitimit të mbetjeve ka mbi 4 fletë me kordinata sepse ka shumë pika dhe na u duk dokumentacion që nuk ju vllente ju.

Këshilltar E.Nexhipi: Gjithsesi nëqoftëse na i paraqesni ti kuptojmë, të na i shpjegoni sepse unë vetë nuk i lexoj dot.

Drejtoresha e Urbanistikës Zhaneta Lubonja: Po nuk ka çfarë tju shpjegosh atyre çdo lëvizje pike këtu në hartë ka një kordinatë X,Y dhe Z që janë shumë teknike.

Këshilltar E.Nexhipi: Ne jemi organ vendimarrës politik nuk mund të diskutojmë tani kordinata është minus 1 apo minus 2.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, përsëri fjalën në lidhje me këtë pike të rendit të ditës?

Këshilltar I.Bode: Unë jam pjesërisht dakort me Z.Nexhipi , them pjesërisht sepse e para që edhe pse mund të mos jemi të gjithë të aftë për të gjykuar mbi çështjet teknike ne në fund do të marrim një vendim dhe për këtë vendim do ngremë dorën e aprovuam apo jo, por pa u sqaruar cilat janë dhe si janë ndryshimet si mund ta ngremë dorën dhe të miratojmë?

Tjetra në projektvendim pika 1 thotë të miratojë ose (mos miratojë ) rishikimin e planit të përgjithshëm vendor nuk janë të sqaruar për një pike, dy ose tre por thotë rishikimin e planit të përgjithshëm vendor, unë nuk e ve në dyshim që janë vetëm këto 3 pika nuk e vë në dyshim as që është mire ti miratojmë dhe sidomos kur thotë sipas materialit bashkëngjitur sepse këtë do ja dërgojmë dhe Z.Kryeministër po e pa që është e pa plotë me atë gojë që ka ai mos na thotë ndonjë gjë tjetër. Ne do marim vendimin dhe duke qënë se do marim vendim jemi apo sjemi të gjithë të aftë për të gjykuar do ngremë dorën kështu që.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të them diçka të lutem?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po kryetar fjala për ju.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rast se duam ti kompikojmë gjërat mund ti komplikojmë sa të duam, unë besoj që në nivelin e vendimmarrjes që ka këshilli që nuk është një vendimarrje e kontrollit të koordinatave harta që është bashkëngjitur që tregon formën edhe sipërfaqen që kërkohet ti ndryshohet destinacioni në plan rregullues është e mjaftueshme. Tani në rast se ti pretendon apo mendon se po të jepte Zhani 4 faqe me kordinata të vend depozitimit të mbetjeve se ka formën e çregullt ai prandaj ka 4 faqe me kordinata, ti do hyje dhe do i kontrolloje të gjitha pikat me kordinata se mos kishte bërë ndonjë gabim Zhani?

Dikush që është ekspert i kordinatave nuk duhet ta bëjë këtu në këshill këtë bisedë por e ka mundësinë të shkojë në zyra të marrë kordinatat të shkojë në komision të marrë koridnatat të rrijë në kompjuter ku di un 2 muaj ti futë kordinatat në kompjuter ti kontrollojë se mos ka lëvizur ndonjë pike në vend depozitimi i mbetjeve inerte dhe është shumë problem i madh pastaj si do e zgjidhim dhe vijmë në mbledhje dhe bëhemi pak eficientë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit ka kërkuar fjalën Z.Pllaha.

Këshilltar K.Pllaha: Përshëndetje të gjithëve nuk besoj se është çështje teknikaliteti për mendimin tim ajo që mungon tek ky material është një relacion se cila është nevoja për të ndryshuar destinacionin e këtyre zonave, si ka erdhur kjo kërkesë, çfarë analize është bërë dhe mbase dhe procesverbali i diskutimit publik që është bërë me qytetarët e zonave përkatëse, këto do ishin një gjykim politik jo kordinatat më vete dhe meqënëse këto mungojnë unë propozoj mos e futim në rendin e ditës, nëqoftëse ka urgjencë mund ta shqyrtojmë në një mbledhje jashtë radhe sa më shpejt të jetë e mundur kur të kemi dokumentin e plotësuar për këto pika.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, nëqoftëse ka diçka tjetër me pika të tjera të rendit të ditës që mos ndalemi përsëri në këto pika që trajtuam.

Këshilltar P.Tollkuci: Përshëndetje Znj.kryetare, përshëndetje kolegë unë mendoj që është një pike që është në shërbim të komunitetit dhe nuk kemi pse e trajtojmë kaq teknikalisht kështu që unë mendoj që ta përfshijmë në rendin e ditës dhe e hedhim në votë së bashku me propozimin që bëri kryetarja e këshillit dhe më pas kur të vijë momenti i duhur sepse tani po konsumojmë kohë dhe

ka goxha pika materiale që ne duhet ti diskutojmë, prandaj unë propozoj që të hedhin në vote rendin e ditës dhe më pas vazhdojmë sipas secilës pike, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Z.Tollkuci, nëqoftëse këshilltarë të tjerë kanë diçka në lidhje me pika të tjera të rendit të ditës jo me këtë pike sepse u konsumua e gjithë pjesa konsultative.

Këshilltar E.Bregu: Kam unë me të tjera.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Urdhëroni.

Këshilltar E.Bregu:Në lidhje me rendin e ditës për sa i përket pikave të tjera bëhet fjalë që proceverbalet e mbledhjeve të dates 25 janar dhe dates 15 shkurt nuk kanë erdhur së bashku me setin e dokumentave por kanë erdhur dje që është jashtë afateve dhe mendoj që kjo nuk na jep mundësinë për ti lexuar ato përderisa nuk është në përputhje me procedurën nuk ka pse futet në rendin e ditës ndaj propozoj që këto mos miratohen sot por të futen në mbledhjen tjetër, për sa i përket çështjes në fjalë për miratimin e planit të përgjithshëm vendor nuk është çështja teknike nëse është kjo kordinata apo tjetra por për sa kohë thuhet që në përshkrim janë bashkëngjitur edhe këto dokumenta është një procedurë që duhet respektuar me përpikmëri, në rast mosrespektim i procedurës materiali nuk është korekt me rregulloren e këshillit dhe nuk duhet të hyjë në rendin e ditës, ky këshill apo ai këshilli i mëparshmi ka miratuar një rregullore e cila duhet të respektohet me përpikmëri me qëllim që të lehtësojmë mardhëniet e këtij këshilli, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për mendimin tuaj.

Këshilltar E.Nexhipi: Kam një sygjërim, për të përmirësuar materialin që ka erdhur për këtë pjesën e sygjëruar edhe nga këshilltari Pllaha, sygjëroj që në realcion të shtohet nga një paragraf për secilën zonë dhe në projektvendimi të ketë specifikim jo dokument i bashkëngjitur por të përfshihen këto 3 që ne po marim vendim që mos jetë e hapur, mendoj se kjo çdo dilemë, çdo arsyetim teknik e zgjidh dhe ndërkohë unë i kam kërkuar sekretares që të na vendoset në dispozicion dhe relacioni, unë isha në mbledhjen që u bë dhe konsultimi publik të shumëfishohet dhe të jetë, ndërkohë derisa të vijmë tek kjo pike të ketë disa kopje për tu shqyrtuar pra për ta përmbledhur e para relacioni të shtohen 3 pikat, vendndodhjet me një përshkrim të shkurtër dhe pse, kjo që kemi thënë me fjalë e thamë dhe në komision, në projektvendimi të shtohet pika 1,2 dhe 3 dhe të shpërndahet relacioni që këtë ta kalojmë sot kjo është ideja, megjithatë ju e dini si do e bëni propozimin dhe miratimin.

Drejtoresha e Urbanistikës Zhaneta Lubonja: Kush ka interes që ti shikojë kordinatat, ja u tregojmë.

Këshilltar D.Osmani: Të bëj një propozim meqënëse jemi tek kjo pike qoftë me kordinatat qoftë teknike, qoftë jo teknike pak a shumë situata për gjithë secilin nga ne mori një kuptim edhe besoj se dhe shqetësimi ishte i drejtë dhe mos ndalemi tek kjo pike meqënëse kemi dhe pika të tjera nuk përbën ndonjë shkelje apo problem për këshillin që ta shtyjë në një mbledhje tjetër ndoshta jo të rradhës që të plotësohet dhe të gjithë të kemi informacionin e duhur, nuk mund të bëhet tani të shkojë drejtoresha të bëjë dhe të na jape informacion apo ku di unë gjëra të tilla.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Së pari do ju tërheq edhe njëherë vëretje këshilltarëve që janë pjesë e komisioneve të marrin pjesë në komision dhe këto problem teknike ti zgjidhin brenda komisionit

dhe së dyta pjesa për të cilën u ndalët për mos miratimin e rendit të ditës ka të bëjë me dy pika të rendit të ditës.

Këshilltar D.Osmani: Kush është pjesë e komisionit?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk po flas vetëm për ty Devis, të lutem mos e mer personale.

Meqënëse kemi 2 pika të rendit të ditës për të cilat ne u ndalëm, së pari po kaloj pikën 8 të rendit të ditës kush është dakort me këtë ndryshim të ardhur për paketën fiskale për pikën 8 të rendit të ditës?

### **Pika 8 e rendit të ditës.**

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në pikën 16 të rendit të ditës, kush është dakort për të futur këtë pike në rendin e ditës me ndryshimet e sygjeruara në relacionin bashkëshoqërues?

Këshilltar D.Osmani: Si do ta shqyrtojmë ne këtë material?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë kush është dakort me pikën 16?

Këshilltar E.Bregu: Procedura nuk është me votë, është shkelur procedura, atëherë para se të hedhesh këtë duhet të hedhesh në votim ndryshimin e rregullores të këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem nuk të kam dhënë fjalën.

Këshilltar E.Bregu: Po ti po shkel procedurën, atëherë para se të shkelësh procedurën na jep të drejtë ne të bëjmë diçka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ja u dhashë mundësinë për të diskutuar.

Këshilltar E.Bregu: Po çfarë mundësi na dhe materiali duhet të vijë 5 ditë para minimalisht nëqoftëse mund të ndryshohet rregullorja mund të pranojmë këtë ndryshim në të kundërt nuk ka pse pranohet ky ndryshim dhe hedhja në votë e kësaj është e paligjshme po shkel ligjin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dakort mos e voto, kush është dakort me këtë pike të rendit të ditës?

Këshilltar D.Osmani: E para e pranuat në këshill që materiali është i paplotë, e dyta po ju bën presion këshilltarëve për ta votuar sepse e kërkoni ju.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Nexhipi propozoi ndryshimet.

Këshilltar D.Osmani: Po pra propozoi por e pranoi që materiali është i mangët.

Këshilltar E.Bregu: Ka nevojë për tu bërë një akt procedural rregjistro kourumin sepse ne po dalim jashtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atë e di unë.

Këshilltar E.Bregu: Po si e di ti vetëm ti di ta lexosh rregulloren ne nuk dime?

Këshilltar I.Bode: Po flisni gabim ne nuk mund të votojmë diçka që është në shkelje të rregullores, patjetër që mund ta votoni por materiali i paplotë nuk mund të merret në shqyrtim dhe nuk mund të plotësohet tani sepse do meremi me pika të tjera.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është i plotë u vu në dispozicion, unë jam dakort dhe të gjithë këshilltarët u dakortësuan që të reflektohen në relacion shtesat dhe kur të vijë momenti i votimit mund ta votoni ose jo.

Këshilltar I.Bode: Nëqoftëse materiali është i paplotë dhe ne minimalisht 5 ditë para ne duhet të njoftohemi për materialin që do të votojmë, si mund ta futim tani gjatë mbledhjes ta shqyrojmë është shkelje e rregullores?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Z.Irvin Bode është pjesë e komisionit të infrastrukturës dhe nuk ishte në mbledhjen e komisionit.

Këshilltar I.Bode: Nuk ka lidhje mund të jem ose mund të mos jem.

Këshilltar E.Bregu: Për këtë shkelje unë propozoj të marrin masa.

Këshilltar E.Nexhipi: Por kjo është llogjika mund të jesh mund të mos jesh por dhe mund të jesh dakort dhe mund të mos jesh, po diskutojnë materialin që nuk e kanë marrë fakti që e kanë marrë por është i shprehur në gjuhë teknike.

Këshilltar I.Bode: A mundet dikush nga ju këshilltarë të hapë emailin dhe të shohë se sa i plotë është materiali, në zarf ka shtesë materiali.

Kryetari i Këshillit A.Verushi:Ka erdhur dikush nga ju për të mare materialet e printuara?

Këshilltar E.Nexhipi: Materialet janë shpërndarë të plota.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Rezultati ju lutem.

**Pika 16 e rendit të ditës për tu futur në rendin e ditës.**

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretare e Këshillit E.Naçi: 21 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, një pjesë nuk morën pjesë në votim.

Këshilltare A.Zheku: Sa një pjesë?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Pjesa tjetër pra.

Këshilltar E.Bregu: Lista e pjesëmarrësve në votim.



Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka këtu një njeri që e drejton mbledhjen.

**Pika 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25- JANAR 2024 DHE DATËS 15-SHKURT 2024.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort me pikën 2?

Këshilltar D.Osmani: Për pjesën e procesverbalit, e para njëherë Elvini të bëri një pyetje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem sespe e kam hedhur në votim.

Këshilltar D.Osmani: Po mos e hidh në votim sepse unë e kërkova fjalën para votimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju pyeta nëse ka diçka me pikat e tjera të rendit të ditës nuk pati, elvini e tha e morëm në shqyrtim po e votojmë.

Këshilltar D.Osmani: E kisha dorën ngritur, procesverbali u dërgua dje pasdite i plotëson kriteret procesverbali ?

Sekretare e Këshillit E.Naçi:Nuk ka afat procesverbali, po të doni mos e miratoni e shtyjmë për mbledhjen tjetër për mua nuk problem por nuk është se ka afat të përcaktuar si materialet.

Këshilltar D.Osmani: A është material proceverbali apo jo?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Është thjesht një konfirmim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është thjesht dhe vetëm konfirmimi i fjalëve që keni thënë.

Këshilltar E.Bregu: Që ta konfirmojmë duhet ta lexojmë.

Këshilltar I.Bode: Znj.Kryetare nuk mund të punojmë me dy standarte nëqoftëse shtyhet pika për procesverbalin atëherë nuk ka pse mos shtyhet dhe pika e shqyrtimin e vendimit të planit rregullues.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 20

Vota KUNDËR 6

Vota ABSTENIM 0

**Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në rendin e ditës në përgjithësi të gjithë rendin e ditës, kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 3 e rendit të ditës.**

**MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 JANAR 2023.**

Këshilltari E.Mitre: Përshëndetje të gjithë këshilltarëve, atëherë për muajin janar janë 58 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar është materiali i përmuajshëm që ne e kemi votuar për këto familje në nevojë, për janarin është fondi në dispozicion 241 mijë e 340 lekë si 6% e fondit të kushtëzuar nga ky fond përfijojnë 58 familje sic e thamë dhe më lart me shumën 199 mijë e 580 lekë po nga ky fond përfitojnë kompesim të energjisë elektrike 20 familje në shumën 23 mijë e 816 lekë, pagesa totale nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike plus energji është 223 mijë e 396 lekë, përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor 17 familje të miratuara me fond prej 64 mijë e 926 lekë i keni të përcaktuara shumë saktë në material, ju ftoj ta votojmë këtë material të sjellë nga drejtorja e kujdesit social, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës nga këshilltarët apo diskutim nëse jo e hedhim në votim?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 4 e rendit të ditës.**

**" MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL " SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përsëri komisioni ju lutem.

Këshilltari E.Mitre: Programi social i strehimit për subvencionimin e interesave të kredisë ka mbështetur të gjithë individët që kanë nevojë, ne kemi miratuar dhe në mbledhjet e kaluara dhe kriteret për pikat në të cilat mbështet kriteret për familjet përfituese, në përgjigje të njoftimit publik të bashkisë të Korçës, thirrjes për aplikime ju janë përgjigjur disa familje dhe nga këto

kanë përfituar 4 familja kësaj rradhe, lista vazhdon është një listë që vazhdon të plotësohet me aplikantë të tjerë të cilët duhen të plotësojnë dokumentin ashtu si na e paraqiti dhe drejtorja e strehimit social me të plotësuar dokumentacionin do i paraqesim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, diskutim nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 5 e rendit të ditës.**

" MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT " PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA "

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përsëri komisioni ju lutem.

Këshilltari E.Mitre: Atëherë nga një shkresë e ardhur nga ministria e financave dhe ekonomisë mbi fondet për programet e strehimit 2024, bashkia Korçë ka marrë njoftimin për çeljen e thirrjes për aplikime për mbështetjen buxhetore të zbatimit të disa projekteve për investime në strehim në dy programe i pari është në banesat sociale me qira dhe i dyti përmirësimi i kushteve të banimit në komunitete të varfra dhe pafavorizuara, komisioni ka konstatuar domosdoshmërinë për ndërhyrje në disa objekte kolektive për shkak edhe të amortizimit dhe për shkak të pamundësisë ekonomike të familjeve që banojnë në kushte të vështira ekonomike kanë bërë domosdoshmëri për të kryer disa punime për rikonstruksione në çati, hidroizolim tarrace dhe punime të tjera të cilat kryesisht janë 55 familje për muajin mars 2023 e deri në shkurt që jemi 2024 ky program dhe kryesisht programi i financueshem përmirësimi i kushteve për banesat ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara do të bashkëfinancohet me buxhetin e shtetit në raport 40% Bashkia Korçë dhe 60% qeveria nëpërmjet ministrisë përgjegjëse, janë 8 milion e 800 mijë lekë nga bashkia dhe 22 milion lekë nga qeveria, janë familje në nevojë detyrimi ligjor i bashkisë është që komuniteti rom dhe egjiptian të mbulohet 5% në këtë program ndërkohë që bashkia ka plotësuar pothuajse 28 % e ka rritur numrin e përfituesëve, unë ju ftoj ta miratojmë këtë material, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të bëj një sqarim të vogël?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: 35 është vetëm një pjesë e listës të familjeve përfituese pasi për shkak se këto ndërhyrje parashikohen që të kryhen një pjesë e tyre në banesa kolektive, numri total i përfituesëve është rreth 220 familje dhe ndërhyrja parashikohet që të kryhet në 20 objekte nga të cilat 16 janë banesa kolektive dhe 4 banesa individuale, më tepër për të saktësuar këto shifra të

përfituesëve, ka disa vite që ky projekt ka filluar dhe bashkëfinancohet nga ministria e financave edhe nga bashkia dhe është një projekt që me sa e kam parë vlerësohet nga komuniteti për impaktin që ka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar E.Bregu: Kisha një pyetje e cila është më shumë ligjore, doja të dija nëse ky trajtimi i një pjesë të familjeve me prioritet dhe bëhet fjalë për shuma të konsiderueshme është shkelje ligji normativ duke qënë se nuk i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë taksapaguesit në bashkinë e Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani është e pamundur që në një projekt të ndërhysh në të gjitha banesat kolektive që banojnë që vijnë nga komunitete në vështirësi apo në nevojë ekonomike ti trajtosh me projektin e një viti, kështu që bëhet me përzgjedhje siç e keni dhe në relacion nga drejtorja e strehimit në Bashki, nga drejtorja e urbanistikës dhe evidentohen nga informacioni që marim kryesisht nga rajonet administrative marim kërkesa, marim një listë objektësh që konsiderohen emergjente verifikohen në vend dhe përzgjidhet një listë, është viti i pestë a i gjashtë që ne vazhdimisht aplikojmë në këtë projekt dhe investojmë tek këto banesa, përzgjidhen në bazë të gjendjes të objekteve dhe nga dëshira që kanë për të aplikuar.

Këshilltar E.Bregu: Nuk ishte kjo pyetja, pyetja ishte është në shkelje të ligjit normative ky lloj trajtimi, nuk trajtohen në mënyrë të barabartë dhe besoj se kjo është një çështje që i përket sektorit juridik për të dhënë një përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të lutem se po na fute kështu nga ana juridike bëje pyetjen tamam, nuk ka ligj normativ ka akte normative që kanë fuqinë e ligjit dhe nuk e marrim në vendimin e mer qeveria dhe më pas miratohen në parlament. Për cilin ligj bëhet fjalë që është shkelur?

Këshilltar E.Bregu: Ana ligjore është e saktë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po patjetër është e saktë.

Këshilltar K.Pllaha: Me sa kuptova nga materiali janë familjet që bëjnë aplikimet e tyre online në sistem nëpërmjet E-Albania, dhe vura re që janë vetëm dy familje nga zonat rurale, përshtypja ime është që numri i familjeve që jetojnë në kushte vërtet të vështira, mendojnë që këto familje që janë në kushte të tilla ekonomike ndonjëherë e kanë dhe të pamundur që të aksesojnë internet për të aplikuar kështu që sygjërimi im është të nxiten kryetarët e njësive administrative që të aplikojnë ata për familjet në nevojë për të përfituar nga ky fond.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ai shqetësimi qëndron por shkak që ka pak aplikime nga zonat rurale nuk vjen për shkak se janë të painformuar apo se ju mungon aksesi në internet sepse ajo është një gjë që mund ta zgjedhim ne me strukturat tona, problemi kryesor që kanë këto familje në zonat rurale të paktën çfarë kemi hasur ne është mungesa e dokumentacionit të pronësisë dhe kjo i penalizon pasi që të aplikosh online dhe të përfitosh nga kjo skemë duhet të jesh pronar dhe ka shumë banesa që kanë nevojë dhe nuk kanë dokumentin e pronësisë dhe nuk kemi gjetur ndonjë mënyrë sesi ta zgjidhim pasi është kusht, ajo që ngritët ju nuk qëndron sepse atë e zgjidhim me mënyrat tona.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

**Pika 6 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE PËR BURSA PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Mbështetur në VKM 666 të dates 10.10.2019 për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe vendimi 511 datë 27.07.2022, ndërrmarja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdhes kërkon shtesë për disa bursa për nxënës të cilët në pamundësi ekonomike kanë plotësuar dokumentacionin përkatës janë 27 nxënës të cilët do të përfitojnë bursa nga fondet e bashkisë dhe kanë plotësuar me vonesë dokumentacionin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, diskutim nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 7 e rendit të ditës.**

" MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1 TË MARRËVESHJES NR.10216/1 PROT.DT.25.11.2022 NËSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR."

Këshilltar K.Kocibelli: Faleminderit Znj.Kryetare, kjo pikë ka të bëjë me një marrëveshje të mëparshme që ka bashkia me shoqërinë rajonale ujësjellës kanalizime Korçë e vitit 2022 dhe sipas kësaj marrëveshje shoqëria rajonale e ujësjellës kanalizime Korçë ka luajtur rolin e agjentit tatimor në lidhje me mbledhjen e taksave dhe tarifave, përveç disa taksa dhe tarifave do i shtohen dhe disa taksa të tjera, të cilat kanë të bëjnë me taksën mbi token buqësore, tarifën vjetore të shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve, parcelave dhe sistemit kullues, në këto kushte komisioni është dakortësuar tja kalojë këshillit këtë pike.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar E.Bregu: Kam përshtypje që kjo pika 7 lidhet me pikën 8 dhe ndoshta do të ishte me vend të trajtohej më pare pika 8 pastaj ti vinte rradha pikes 7 sepse nëqoftëse nuk ndryshon mënyra e pagesës ti nuk mund ta ngarkosh agjentin tatimor me lejën e detyrimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këto pika kanë lidhje me njëra- tjetrën.

Këshilltar D.Osmani: Kisha një pyetje në lidhje me përqindjen e ujësjellës kanalizime me % që mban si agjent që është 2%, para pak kohësh do isha dakort sepse të ardhurat që realizon ujësjellësi shkojnë tek bashkia Korçë por duke qënë me ndryshimet e fundit ligjore një pjesë e mire me sa informacion kam është aksioner edhe qeveria kjo 2% mund të diskutohet që këto të ardhura të mos shkojnë jashtë Korçe po të mbeten në Korçë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Për ta sqaruar po i jap fjalën kryetarit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ligji për sistemin e taksave vendore parashikojnë që bashkia për të mbledhur taksa apo tarifa të caktuara mund të angazhojë dhe agjentë tatimor dhe ky agjent jo domosdoshmërisht duhet të jetë i lidhur me bashkinë në kuptimin që ne i japim atij atë tarifën dhe tarifa qëndron brenda bashkisë, mund të kesh agjent tatimor që mund të jetë edhe privat lidhen me mundësinë më të mirë që ti ke për të mbledhur të ardhurat, ti teorikisht mund të pajtosh agjent tatimor edhe për x gjë edhe një kompani private në Tiranë nuk të ndalon njeri llogjika është mënyra më e mirë për të mbledhur të ardhurat sepse na ka treguar deri tani që për qytetin e Korçës që falë marrëveshjes dhe caktimit të ujësjellësit si agjent tatimor ne kemi arritur që të mbledhim një përqindje shumë të madhe të të ardhurave që mund të mbledhim potencialisht kjo që nga viti 2008 e në vazhdim dhe tani këtë eksperiencë pozitive duam ta shtrijmë pak edhe në pjesën e fshatrave duke filluar me taksën e tokës dhe me tarifën e mirëmbajtjes të rrjetit të vaditjes dhe kullimit dhe parcelave, kurse për sa i takon pyetjes që mund të negociohet apo jo tarifa këtë e kemi diskutuar në momentin ku e kemi miratuar atë tarifën e ujësjellësit si agjent tatimor dhe në atë moment e kemi negociuar të paktën unë si kryetar bashkia e kam negociuar me ujësjellësin edhe më është thënë që kjo tarifa 2% është vendosur si një tarifë standarte për gjithë ujësjellësit dhe nga ana e akumit që është enti që ka edhe përqindjen më të madhe të aksioneve të ujësjellësit.

Këshilltar D.Osmani: Tani faleminderit për sqarimin, sygjerimi dhe pyetja ime ishte sepse ju si kryetar po dhe ne si këshilltar të bashkisë interesi jonë i përbashkët është që të ardhurat të ngelen në bashkinë Korçë sepse duke qënë që ujësjellës kanalizime Korçë është agjent nuk besoj se është në interesin tuaj që ju të shkoni të gjeni një agjent tjetër jashtë qytetit apo jo?

Unë isha shumë dakort që të jetë ujësjellësi por duke qënë që ujësjellësi aktualisht nuk është 100% i bashkisë dhe me sa informacion kam unë ujësjellësi të paktën ujësjellësi i Korçës është një nga ndërmarjet që është me fitim të pakta ndërmarje që mund të ketë në Shqipëri na interesonte që ky 2% të ishte i bashkisë Korçë tani nuk është më, ta ulë 2% që ta kesh ti të ardhur në bashki.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani nuk është ky diskutimi.

Këshilltar D.Osmani: Po dakort pra pyetje ishte.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kur ishte ujësjellësi i Korçës ne e kishim tarifën 0 në atë moment edhe me kërkesë të Akumit për të bërë një standartizim të tarifës që ujësjellësat të mbajnë në të gjithë vendin si agjent tatimor u kërkua që të jetë 2% dhe ishte një vendimmarrje në nivel vendi kështu që nuk kishte hapësirë për të negociuar diçka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë nëqoftëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 8 e rendit të ditës.**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 153 DATË 07.12.2023 PËR " NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024".**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo pike së bashku me ndryshimin e propozuar për materialin që ka erdhur nga Qendra e Artit dhe Kulturës, komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi lidhur me ndryshimin e vendimit nr.153 datë 07.12.2023 për nivelin e taksave dhe tarifave vendore ka propozuar që taksimi i tokës bujqësore dhe tarifimi i vjetër vjetor i shërbimit dhe mirëmbajtjes dhe sistemit kullues të vendosen në faturën mujore të furnizimit me ujë, kjo bëhet që familjarët të kenë mundësinë e pagesës të shtrirë në kohë, indetifikimin e saktë të taksapaguesve dhe rritjen e arkëtimeve që është qëllimi final, ekzekutivi ka theksuar që kjo vlen vetëm për ata familjarë që kanë kontratë të rregullt me ujësjellës kanalizimet dhe ata familjarë që nuk kanë kontratë do vazhdojnë që ti paguajnë detyrimet në bankat e nivelit të dytë ose në sportelet e njëjësive të administrimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në lidhje me propozimin shtesë që ka ardhur ju lutem nga Qendra e Artit dhe Kulturës.

Këshilltar A.Habip: Qendra e Artit dhe Kulturës ka dërguar një relacion për vendosjen e biletave për galerinë "Guri Madhi" Korçë unë po e lexoj të gjithë relacionin që të jemi sa më të qartë të gjithë. Shumë shpejt do të bëhet inagurimi i Qëndres të Artit dhe Kulturës dhe Inovacionit në qytetin e Korçës, qëndër kjo e cila ju nënshtrua rikostruksionit për të krijuar kushtet më të domosdoshme për të funksionuar arti dhe kultura në qytetin e Korçës, në këtë qëndër do të ushtrojnë aktivitetin e tyre grupet artistike të cilat janë të afishuara pranë kësaj qëndre si Kori "Lira", Banda e Qytetit, Orkestra Simfonike dhe brenda së cilës dhe Orkestra e Harqeve, Asambli Artistik Popullor Skënderbeu dhe Orkestrina Popullore, të gjitha këto grupe

do të kenë ambientet e veta, gjithashtu punojësit e artit dhe kulturës do të kenë ambientet e veta komode për të krijuar, shtuar dhe ritur nivelin artistik të aktiviteteve kulturore dhe artistike, në këtë kuadër pranë qendrës të artit dhe kulturës do të jetë e hapu dhe galleria “Guri Madhi” me vepra nga fondi i galerisë tonë në vite, ky fond është një fond i artë me vepra që kanë vlera artistike dhe historike. Në këtë kuadër ne do të dëshironim kjo ekspozitë do të jetë e përhershme të vizitohet me një biletë me vlerë 300 lekë për person dhe do të aplikohet me 50 % ulje për pensionistët, studentët sipas kartës të studenitit dhe nxënësit e shkollave, si dhe personat me aftësi të kufizuar ndërsa fëmijët nën 14 vjec do ta kenë falas, prandaj kërkojmë mirëkuptimin tuaj që të aprovohet kjo biletë sepse do të rrisë të ardhurat e Qendrës të Artit dhe Kulturës dhe njëkohësisht do i japim rëndësinë e duhur kësaj galerie, në këtë galeri do të ekspozohen vepra të piktorëve Korçarë dhe jo vetëm të cilët në vite janë përzgjedhur nga komisione të specializuara të cilat kanë vlera të jashtëzakonshme artistike dhe historike, ato janë piktura me shumë vlerë dhe nuk do ishte mire të vizitoheshin falas nga publiku, kjo galeri do mundësojë të ekspozojë këto vepra në kushte bashkëkohore.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, nëse ka pyetje nga këshilltarët ju lutem?

Këshilltare A.Zheku: Meqënëse këto janë dy pika le të themi jo me ngjashmëri, janë të veçanta le të vihet me fraksion dhe të votohet veçmas për njërën pikë dhe veçmas për tjetrën, e shtuar ok por votimi të kalojë pika 8/1, ose pika 8/2.

Këshilltar E.Nexhipi: Këto janë pjesë e paketës fiskale dhe patjetër votimi mund të jetë i ndarë nuk ka ndonjë problem por si vendim një do të jetë.

Këshilltare A.Zheku: Vendimi le të jetë një por pikat e votimit të jenë më vete.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Patjetër, ka diçka tjetër nga këshilltarët nëse jo e hedhim në votim, ju lutem me pjesën e parë pa futur ndryshimet e propozuara nga Qendra e Artit dhe Kulturës, kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 9

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë me propozim e ardhur nga Qendra e Artit dhe Kulturës për tu reflektuar në ndryshimin e paketës fiskale e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0



**Pika 9 e rendit të ditës.**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMI NR.31 DATË 23.02.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË PËR KALIMIN E PRONËSISË TË 70% TË TRUALLIT TË DHËNË PËR NDËRTIM NË FAVOR TË Z.ROLAND ZEGULLAJ, PËR EFEKT REGJISTRIMI NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME".

Kryetari i Këshillit A.Verushi:Ju lutem komisioni i çështjeve ligjore.

Këshilltar K.Kocibelli: Shtetasi në rastin konkret subjekti aplikues, në vitin 1999 me vendimin nr.330 ka përfituar lejën e ndërtimit dhe i është kaluar vetëm 30% e pronësisë, tashmë pasi ai ka bërë aplikimin duke i kaluar dhe 70% të pronësisë pasi ka likuiduar të gjitha detyrimet që ka pasur, në këto kushte atij i lind e drejta ligjore që të bëjë një kërkesë pranë bashkisë për kryerjen e kalimit të pronësisë ndodhur në këto kushte edhe në lidhje me këtë pjesë komisioni ka vendosur ta kalojë për miratim këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 10 e rendit të ditës.**

"DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË SIPËRFAQES 300 M2, PJESË E PASURISË 8/145 VOL. 21 FAQE 130,ZK 8562, E LLOJIT TRUALL".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni edhe njëherë ju lutem.

Këshilltar K.Kocibelli: Në lidhje me këtë pike Znj.kryetare ka të bëjë me pasuri të paluajtshme e cila ndodhet tek kodra e qytetit, subjekti aplikues në rastin konkret është fondacioni “Kenedi” i cili është drejtuar në bashkinë Korçë me kërkesën për marrjen në përdorim e një sipërfaqeje prej 300 M2 trualli me një afat 5-vjeçar dhe qëllimi i kësaj kontrate është ndërtimi i një sere e cila do të përdoret për ti ardhur në ndihmë komunitetit pra Qendrës Për Të Moshuar, Qendrës Ditore Për Fëmijët e Braktisur, Qendrës Recidenciale Të Vajzave si dhe projektit të shpërndarjes të ushqimeve të ngruhta për fëmijët në nevojë edhe për këtë pike të rendit të ditës komisioni ka vendosur tja kalojë këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët, diskutim nëse jo e hedhim në votim.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 11 e rendit të ditës.**

PËR " DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË GODINËS KU USHTRON AKTIVITETIN DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË, ME NR. 4/33-ND3 PASURIE, ME SIPËRFQE 1400 M2".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo është një procedurë e cila bëhet çdo vit, ju lutem komisioni.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Para se të flasë komisioni duam tju propozojmë një ndryshim në material në lidhje me këtë pikë, për sa i takon kohëzgjatjes me dhënie për huapërdorje nga 3 vjet që është propozuar të bëhet 6 muaj pasi mendojmë që në harkun e 6 muajve kjo qëndër mund të zhvendoset që këtu dhe më pas këtë godinë mund ta përdorë bashkia për nevojat e saj, pra vetëm për ndryshimin e afatit ta bëjmë nga 3 vjet në 6 muaj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Së pari njëherë kush është dakort në parim me këtë ndryshim nga 3 vjet në 6 muaj, por të flasë komisioni si fillim.

Këshilltar K.Kocibelli: Atëherë unë po e pasqyroj çështjen në parim ka të bëjë me një mardhënie midis dy subjekteve pra agjensisë kombëtare të punësimit dhe aftësimin dhe bashkisë Korçë e cila në vitin 2021 ka pasur një kontratë huamarrje 5-vjeçare ndodhur në kushte që kjo kontratë ka përfituar subjekti AKP-ja i është drejtuar përsëri bashkisë Korçë për të kërkuar rinovimin e kësaj kontrate.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Z.Kryetar na bëtë kurioz tani me këto ndryshimet, keni ndonjë plan se për çfarë do të shfrytëzohet ajo godinë pas 6 muajsh ose ku do të transferohet qëndra?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo godinë ka shërbyer për shumë vite si qëndër e formimit profesional tani në kuadrin e riorganizimit të shkollave të formimit profesional në Korçë besoj që do të bëhet edhe zhvendosja e kësaj qëndre në një prej ambienteve të këtyre shkollave se ku konkretisht nuk e di por kam informacion që brenda 6 muajve kjo mund të lëvizë dhe meqënëse kjo lëvizje do të ndodhë do të duhet ta përdorim pastaj për nevojat e bashkisë, kemi disa nevoja disa kërkesa, një mund ta përdorim si ambient magazinimi për një pjesë të materialeve të shërbimeve publike që janë materiale relativisht delikate dhe nuk mund të ruhen në magazina të mëdha por do shohim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, kush është dakort me propozimin për 6 muaj?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 12 e rendit të ditës.**

PËR NDRYSHIMIN E V.K.M 42 DATË 27.05.2021 " PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE ZHVILLUESIT PRIVAT, SUBJEKTIT SHOQËRIA BIGTAM SHPK PËR DHËNIEN E TRUALLIT PËR NDËRTIM, SIPAS PROCEDURËS TË PËRCAKTUAR NË V.K.B NR.33 DT.25.03.2021 "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR NEGOCIMIN ME ZHVILLUESIT PRIVATË QË SHPREHIN INTERES TË BASHKËPUNOJNË ME BASHKINË KORÇË, NËPËRMJET MARRËVESHJES PËR PRONAT NË PRONËSI TË SAJ".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar K.Kocibelli: Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës Shoqëria Bigtam është subjekt privat ndërtues i cili fillimisht në vitin 2021 ka paraqitur një kërkesë duke shprehur interesin me qëllim zhvillimin e pronave ku një ndër disa prona ka qënë dhe prona e bashkisë që kanë qënë në kufi me pronat që kjo shoqëri ishte duke u zhvilluar, në këto kushte drejtoria e kontrollit planifikimit zhvillimit të teritorit në bashkëpunim me drejtorinë e përgjithshme juridike të burimeve njerëzore kanë arritur në konkluzionin që kërkesa ka qënë në përputhje me planimetrinë e teritorit, duke qënë se një sipërfaqe prej 400 M2 nuk është shfrytëzuar nga drejtuesi i është drejtuar me shkresën datë 20.02.2024 i është drejtuar bashkisë Korçë pra me një sipërfaqe prej 408 M2 nga marrëveshja e mëparshme kjo pasuri nuk është përfshirë në projekti ndaj kërkon që dhe kjo pasuri mos përfshihet në sipërfaqen ndërtimore prej 30% që subjekti detyrohet të kalojë në pronësi të bashkisë Korçë, kjo është çështja në rastin konkret edhe këtë pikë e kemi kaluar për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 13 e rendit të ditës.**

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT TË PRONAVE , IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR.2/12 VOL.27 FAQE 167;NR.2/539-ND,VOL.27,FAQE 168;, TRUALLI NËN NDËRTESËN NR.2/708-N1, PJESË E PASURISË NR.2/10, VOL.33, FAQE 19 SIPAS HARTËS BASHKËNGJITUR.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar K.Kocibelli: Në gjykimin tim meqënëse është dhe kryetari i këshillit të qarkut mund të na japë edhe një shpjegim më të hollësishëm.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë fjala për Z.Nexhipi.

Këshilltar E.Nexhipi: Faleminderit siç mund të jeni në dijeni në vitin 2016 ka filluar investimi në ish-ndërtesën e këshillit të qarkut dhe është bërë më vonë transferimi nga ndërtesa që zotërohej nga këshilli i qarkut në ish-bashkia dhe në ish-ndërtesa e prokurorisë në atë moment është kaluar vetëm një pjesë e ndërtesës dhe për fat është kaluar vetëm ajo pjesë ku nuk ka zyra këshilli i qarkut ne po kërkojmë të kalojmë pjesë e ndërtesës ku janë realisht zyrat e këshillit të qarkut dhe në atë kohë nuk është kaluar as trualli në ndërtesë, kjo ka penguar deri diku dhe funksionimin e institucionit sepse ndërhyrjet në ndërtesë për riparim apo mirëmbajtje të ndryshme duhet të bëhen nga pronari i ndërtesës, në këtë rast jemi në kushtet që përdoruesi është i ndryshëm nga pronari dhe këto ndërhyrje nuk bëhen pra po kërkojmë që të zgjidhet ky ngërc por nuk është një procedurë e thjeshtë sepse ne këtu japim pëlqimin do hidhet pëlqimi dhe nga këshilli i qarkut dhe më pas do kalojë në këshillin e ministrave për miratim, kjo është situata ju ftoj ta votojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Pyetja e parë që kisha është se meqënëse një pjesë i ka kaluar në pronësi por nuk e kanë në përdorim dhe kërkoi që të kalojë kjo pjesa tjetër mos ndoshta mendon që të bëjë këmbim apo do që të shtojë sipërfaqet?

Pyetja e dytë është për të marrë në konsideratë rikonstruksionin, investimet , riparimet, e të tjera meqënëse bashkia Korçë është pronar nuk mund të zgjidhet kjo me një autorizim duhet patjetër të kalojë në pronësi?

Këshilltar E.Nexhipi: E para nuk po kërkojmë shtesë sipërfaqes po kërkojmë atë që jemi, ajo sipërfaqe që aktualisht ne kemi në pronësi por nuk është në përdorimin tonë është në funksion të institucioneve të tjera që kanë qënë të sistemuara edhe në ndërtesa e vjetër, pra thelbi është nuk po kërkojmë të shtojmë sipërfaqe pra të marim shtesë sipërfaqe për funksionin e këshillit të qarkut por zyrat ku zhvillohet aktiviteti të jenë në emrin e atij që i përdor sepse kjo rrit mundësinë për ta mirëmbajtur dhe për ta kthyer në kushte më komode më saktë në kushte normale jo komoditet sepse nuk po kërkojmë komoditet në zyra sepse ajo është një ndërtesë e cila ka nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme, autorizimi nga bashkia mund të bëhet por ligjërisht një person nuk mund të investojë në ndërtesën e dikujt tjetër, në pronën e dikujt tjetër. Autorizimin mund ta bëjë përshembull të thotë lyeje por nëqoftëse duhet sistemi i ngrohjes kush e autorizon këtë?

Megjithatë thelbi është ky institucioni po kërkon të ketë në përdorim atë sipërfaqe që përdor.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të them edhe diçka të vogël ju lutem?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po edhe një sqarim nga kryetari i bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ideja është në momentin që ne kemi shkëmbyer këto godina në parim marrëveshja ka qënë që ne do marrim godinën e këshillit të qarkut ekzistuesen dhe do i japim godinën e ish-bashkisë, tani nuk e di për çfarë arsye mbase Anxhela mund të na i sqarojë u realizua ky transferimi vetëm i njëres pjesë ndërkohë që pjesa tjetër ka ngelur dhe ne ja u kemi dhënë vazhdimisht me huapërdorje dhe është diçka që duhet ta zgjidhim, ajo është një pronë që

duhet ta gëzojë dhe administrojë këshilli i qarkut që ushtron të drejtën atje nuk ka pse ne ta mbajmë si pronë dhe të bëjmë vazhdimisht huapërdorje.

Këshilltar E.Bregu: Po prona që ktheu këshilli i qarkut ishte në emër të këshillit të qarkut?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë të sqaroj diçka, kur janë këmbyer sipërfaqe të barabarta, ndërkohë ajo godinë ka pasur sipërfaqe më shumë se ajo godinë që la këshilli i qarkut aty në ajo godinë, meqënëse në godinën e ish-këshillit të qarkut kanë qënë dhe institucione të tjera shtetërore të cilat ushtruan aktivitetin aty siç ishte prefektura dhe disa drejtori rajonale të gjitha këto institucione erdhën përsëri në godinën e ish-bashkisë Korçë meqënëse nuk kishte mjaftueshmëri zyrash për të ushtruar aktivitetin edhe këto drejtori rajonale këshilli i qarkut u detyrua të marrë në huapërdorje një pjesë të godinës që është në pronësi të bashkisë ajo sipërfaqe e cila nuk ishte pjesë e këmbimit dhe ka kohë që ne kemi kërkuar nga bashkia Korçë të kalojë në pronësi sepse ashtu siç tha dhe kryetari i qarkut nuk mundesh dot të bësh asnjë investim, ajo godinë ka nevojë për tu mirëmbajtur por duke qënë pronarë nuk mundesh dot të investosh dhe ne kemi kërkuar që për këtë pjesë të godinës të meret në pronësi dhe të ndërhyet sepse ka nevojë, kjo është e gjithë ideja.

Këshilltar E.Bregu: E kuptova, faleminderit.

Këshilltar I.Bode: Nga ato që lexoj me sa kuptova, besoj e kam kuptuar mirë do të kalojë në pronësi të këshillit të qarkut dhe godina ku është aktualisht prefektura bashkë me oborrin mbrapa apo jo ?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo atë e kanë në pronësi është pronësi e këshillit të qarkut ajo.

Këshilltar I.Bode: Po 2/708 pra edhe 2/10.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi Dishnica: Trualli 2/10.

Këshilltar I.Bode: Truallin e shoh 2/10 po 2/708?

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi dishnica: (Nuk ka audio).

Këshilltar I.Bode: Pra me sa kuptoj unë nga genplani që na keni paraqitur pasuria 2/708 me 652.88 M2 është vetëm pjesa që zgjatet nga godina dhe jo pjesa ballore e bashkisë, po ku e ka kufirin ajo?

Ska kufi është e gjitha në formë l-je, prandaj them nuk e tregon kufirin në materialin që kam unë të paktën.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi Dishnica: (Nuk ka audio).

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal për ta bërë pak më eficiente nga relacioni sqaroja pak për çdo numër pasurie se çfarë është.

Drejtroia Juridike A.Qeramixhi Dishnica: Atëhere pasura 2/12 dhe kati i parë i pasurisë 2/539 janë objekte këtu kalojnë në pronësi ndërkohë që pasuria 2/708 i kalon turalli në ndërtesë sepse ndërtesën e ka aktualisht në pronësi.

Këshilltar I.Bode: Faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Unë nuk e vë në dyshim që kërkesa e cila vjen nga këshilli i qarkut është për mirëfunksionimin e institucionit dhe megjithatë jam kundër këtij vendimi dhe dua ta argumentoj përgjigjen time, së pari sepse bashkia Korçë dhe Këshilli i Qarkut kanë mardhënie shumë të mira ndëristitucionale besoj se mund të gjenden dhe mekanizmat për të ndërhyrë në atë ndërtesë pa ndryshuar pronësinë, së dyti ajo ndërtesë mbart një histori është ndërtuar për bashkinë e Korçës.

Këshilltar E.Nexhipi: E ke gabim.

Këshilltar K.Pllaha: Më falni këtu tërhiqem, pavarisht kësaj në atë godinë ushtrojnë funksionet disa institucione të tjera nëqoftëse çdo institucion shtetëror që ushtron aktivitetin në bashkinë e Korçës do kërkonte godinat ku ushtron funksionet atëherë i bie që bashkia e Korçës nuk do të kishte më prona do kishte vetëm këtë godinë dhe kjo gjë në parim nuk qëndron dhe për më tepër unë besoj se me ndryshimet që do të ndodhin së shpejti në ndarjen territoriale këshilli i qarkut mund edhe mos ekzistojë më ku do të shkojë kjo pronë, jemi të sigurt që do i kalojë bashkisë apo bashkia e ka humbur përfundimisht pronësinë e saj?

Për këtë arsye jam kundër dhe nëqoftëse është për mirë funksionalitetin mund ta zgjidhin edhe ndryshe, ne si këshill kemi pavarisht se mbështesim këshillin e qarkut dhe duam që të funksionojë sa më mirë kemi detyrimin që të mbrojmë edhe pronat e bashkisë dhe ti shfrytëzojmë maksimalisht ato.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Me përjashtim të pjesës historike që nuk është ashtu por nuk po i hyjmë këtij diskutimi ky material vjen si rrjedhojë e një procesi që ka filluar disa vite më parë, nuk është se këshilli i qarkut ishte pa pronë dhe ne tani po duam ti japim një pronë, këshilli i qarkut e kishte një pronë në krahë të Katedrales dhe kemi bërë marrëveshje që ti shkëmbejmë këto prona dhe kjo ka ngelur pa u relaluzuar deri tani për shkak të një teknikaliteti nuk ishin të rregjistruara x prona por marrëveshja ka qënë që do na jepni këtë godinë dhe do ju japim këtë godinë, kjo qënë marrëveshja me këshillin e qarkut nuk është se ishte një institucion që ushtronte aktivitetin e tij në pronat e bashkisë historikisht dhe tani po kujtohem ti japim një pronë e ka pasur pronën ku suhtronte aktivitetin e kemi shkëmbyer për shkak të aktivitetit më të madh, kanë rënë dakort, tani duhet ti qëndrojmë pjesës tonë të marrëveshjes, bëhet fjalë për institucione qëndrore siç janë prefektura edhe këshilli i qarkut që nuk janë drejtori të çfarëdollojshme që ti hyjmë këtij diskutimi pse duhet ta kenë.

Këshilltar K.Pllaha: Prefektura nuk ka kërkuar pronësi apo jo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Prefektura nuk ka pasur pronësi, prefektura dhe në godina e vjetër ka qënë në godinën që administronte këshilli i qarkut, tani nuk mundemi ta “zhveshim” këshillin e qarkut pavarisht kësaj procedurës të më vonëshme që nuk e dimë, shiko se kush do jetë produkti

i reformës të ardhshme teritoriale këtë nuk mund ta dimë, mund të qëndrojnë apo jo këshillat e qarqeve, mund të shndërrohen në organe më të mëdha rajonale që të mbulojnë rajone më të mëdha se qarku i Korçës nuk e dimë ne këtë gjë, unë asnjëherë nuk jam dakort që bashkia të heqë dorë nga asetet e saj si rregull njëherë por në rastin konkret historiku ka qënë kështu këshilli i qarkut e ka pasur një aset ja ka dhënë bashkisë dhe në këmbim duhet ti japim asetin ku ushtron aktivitetin.

Këshilltar K.Pllaha: Gjithsesi meqënëse nuk e ushtron aktivitetin në të gjithë godinën, mund të kthejë tani pjesën që aktualisht e ka apo nuk ushtron aktivitetin?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ne në atë godinë gjithsesi po mbajmë pjesën që përdoret nga bashkia, pra kemi zyrat e ndërrmarjes të shërbimeve publike dhe të rajonit administrativ numër 2, pra katin përdhe të njëres godinë do vazhdojmë ta mbajmë atje ku ushtrojmë nevojat tona, pjesën tjetër ku ushtron aktivitetin qarku ok edhe mund ta mbajmë tani tju themi që nuk duam tja u japim por nuk është korekte.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Z.kryetar për sqarimin, atëherë e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 7

Vota ABSTENIM 4

Këshilltar K.Pllaha: Znj.kryetare tjetërsimi i pronave kalon me tre të pestat.

Këshilltar E.Nexhipi: Nuk e tjetërsojmë ne këtu.

Këshilltar E.Bregu: Më falni sepse po ndërhy pa rradhë ky pëlqim është pjesë e procesit të tjetërsimit, sepse tjetërsimi është një proces i tërë, tjetërsimi nuk bëhet as tek noteri as tek hipoteka por është një process i plotë, atëherë me thuaj momentin e tjetërsimit tek noteri apo tek hipoteka?

Drejtoria juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Kjo bëhet me vendimin e këshillit të ministrave.

Këshilltar E.Bregu: Këshilli i ministrave ai vendos atëherë pse na i sjell për votim ne?

Mos na i sill për votim fare le ta vendosë këshilli i ministrave. Tek procesi i votimit duhet me tre të pestat, nuk kalon kështu është ligji tip po të duash kaloje.

Këshilltar K.Pllaha: Kë quajmë process tjetërsimi të pronave të bashkisë përveçse dhënien e pëlqimit për tjetërsim?

Drejtoria juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Duhet të shkojë ta rregjistorjë në Agjensinë Shtetërore të Kdastrës dhe këtë gjë nuk e bën dot sepse nuk njihet vendimi i këshillit të bashkisë akt me të cilin mund të bëhet kalimi i pronësisë, kalimi i pronësisë bëhet me vendim të këshillit të ministrave.

Këshilltar K.Pllaha: Të çdo pronësie?

Drejtoria juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Të pronave publike po flasim.

Këshilltar K.Pllaha: Atëherë i bie që këshilli bashkiak nuk është pronar i pronave publike.

Drejtoria juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Është pronar.

Këshilltar K.Pllaha: Atëherë perderisa është pronar dhënia e pëlqimit domethënë tjetërsim.

Këshilltar E.Bregu: Do të thotë që vendimi ka vlerë të numërohet sipas procedurës.

Drejtoria juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Kemi një akt të procesit të transferimit në pronësi kjo është dhënia e pëlqimit.

Këshilltar K.Pllaha: Si interpretohet pjesa e rregullores të këshillit bashkiak?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë nuk jam jurist por ajo që thotë Anxhela është kjo që ky akt do të quheshe akt tjetërsimi dhe do të duheshe ai lloj votimi që thoni ju në rast se me këtë akt mbaronte procesi, pra me këtë akt shkonte ai përfituesi siç mund të miratojmë kot po them një dhurim, kurse ky është një akt i ndërmjetëm thot Anxhelan, unë nuk jam jurist por këtë kuptova.

Këshilltar E.Bregu: A mund ti kërkoj komisionit të ligjeve të shprehet?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem Kristi edhe njëherë, meqënëse këshilltarët kërkuan të shprehet komisioni i ligjeve.

Këshilltar K.Kocibelli: Sipas rregullores të këshillit bashkiak dhe në nenin 82 të rregullores janë përcaktuar të gjitha rastet se kur miratohet qoftë me shumicë të thjeshtë, qoftë me shumicë të cilësuar pra dy lloje shumicash kemi ne, në rastin konkret çfarë shumice ka si të thjeshtë si të cilësuar. Numri sa shkoi?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: 21.

Këshilltar K.Kocibelli: Pra në rastin se ne shohim nenin 82 do e kuptojmë atje se në cilat raste futet kjo pike e rendit të ditës, pra hpe rregulloren e këshillit bashkiak dhe e shohim.

Drejtoria juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Në këtë rast akti administrative që bën vendimin është këshilli i ministrave jo vendimi i këshillit të bashkisë, ky është koncepti i tjetërsimit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E ka ligji dhe rregullorja kanë marrë ligjin dhe e kanë vënë në rregullore, bihen dakort që ligji thotë që tjetërsimi bëhet me tre të pestat e gjithë anëtarëve të këshillit.Ky akt quhet tjetërsim apo jo?

Këndvështrimi i drejtorisë juridike është që akti të quhet tjetërsim duhet të jetë akti përfundimtar me të cilën përfituesi shkon dhe bën veprimet në hipoteke.

Këshilltar K.Kocibelli: Këshilli bashkiak nuk ka të drejtë asnjëherë, të tjetërsojë pronat ne kemi të drejtë vetëm të japim pëlqime dhe pasi japim ne pëlqimin, janë institucione të tjera që kryejnë veprime.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem ti lemë dy minuta të mblidhet komisioni i ligjeve dhe të na vijë me një vendim përfundimtar.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Komisioni i ligjeve, Z.Erjon Nexhipi, Znj.Edlira Mitre, Z.Erjon Kurti, Z.Kristiano Kocibelli, Znj.Ismeralda Seidolli.



Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë në emër të komisionit kush do e mare fjalën?

Këshilltar K.Kocibelli: Pasi studiuam dhe analizuam përsëri si ligjin ashtu dhe rregulloren, është e vërtetë që këshilli bashkiak i Korçës ka kompetencë që të tjetërsojë pronë apo të japë ato në përdorim, konkretisht në nenin 54 të ligjit pika E, gjithashtu dhe për sa i përket rregullores në nenin 81 caktohen edhe rastet e tjetërsimit që është vërtetë me tre të pestën por ne mendojmë që në rastin konkret jemi para dhënies të pëlqimit pra nuk është këshilli bashkiak organi që bën tjetërsimin në rastin konkret këtë vendosi komisioni, në ras se dhe anëtarët e këshillit bashkiak janë dakort.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, në rast se ka nevojë të votohet, sepse ajo u votua, atëherë edhe kjo pike kalon.

### **Pika 14 e rendit të ditës.**

**PËR KALIMIN E PRONËSISË SË TRULLIT PREJ 250 M2 TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA ISH KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT KORÇË NË EMËR TË Z.ARJAN ZGURI.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar K.Kocibelli: Edhe me këtë pikë të rendit të ditës subjekti përkatës ka bërë kërkesën, pasi ka plotësuar gjithë dokumentacionin edhe në lidhje me plotësimin e kërkesave dhe sipas vendimit të këshillit të ministrave, komisioni vendosi tja kalojë këshillit për miratim duke qënë se ky subjekt e ka plotësuar dokumentacionin në mënyrën e duhur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltar I.Bode: Atëherë nuk jemi përballë të njëjtës situatë që ne po tjetërsojmë një pronë dhe do na duhet shumicë e cilësuar?

Drejtorja juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Kjo është situatë tjetër pasi ka të bëjë me kalim pronësie jo dhënie pëlqimi dhe po këtu duhen tre të pestat.

Këshilltar E.Nexhipi: Një shpjegim i vogël, këtu bëhet fjalë për shtëpinë që ka ndërruar në një vend të dhënë nga këshilli i rrethit çfarë ka qënë atëhere, nuk bëhet fjalë për një truall të ri që do e japim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Raste të tilla kemi pasur edhe në mbledhjet e mëparshme do kemi edhe në mbledhjet e ardhshme, pra është një praktikë ligjore për këto raste që ne duhet të japim këtë miratimin.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 15 e rendit të ditës.**

**PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE PËR VITET 2024-2026.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar E.Nexhpi: Është në praktikën e këshillit bashkiak që miraton prioritet e investimeve në planin afatmesëm, kjo është një listë e azhionuar tashmë nuk e di duhet të keni marrë në dispozicion sepse pasi u mbledh komisioni gjykuam që disa nga prioritetet e vendosura duhet të bashkoheshin ose të azhiornoheshin me me vlera që ishin realizuar tashmë, pavarësisht që ne e miratojmë këtë listë kjo mbetet një listë e hapur për prioritetet e tjera që mund të vijnë në një periudhë të ardhshme, në rast se nga këshilltarët ka ndonjë sygjërim besoj se këshilli do e marrë në konsideratë bashkë me ekzekutivin, ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të bëj një sqarim se mbase ju paraprij pyetje që ju do bëni, pra në vijim të asaj që tha dhe Erjoni kjo është një listë prioritetesh e cila i nevojitet bashkisë për të realizuar projekte të caktuara, pra ne na nevojitet që para se të realizojmë një projekt duhet ta kemi në listën e prioriteteve ndërkohë që lista është e hapur nëse do keni projektide të tjera, nuk është se vlera i përkon një prevetivi të hartuar përfundimtar janë vlera indikative me një vlerësim që ka bërë drejtorja e urbanistikës, në rast se një projekt nga kjo listë prioritetesh na miratohet pastaj ne punojmë dhe bëjmë projektin e detajuar prevetivin përkatës dhe vazhdojmë procedurën siç e ka ligji.

Këshilltare A.Zheku: Përderisa kemi prioriete kemi një listë, të listuar me numra nga 1 në x dhe nga a-ja në zh pra ky prioritet nga a-ja janë të parët do të thotë që ka prioritet a-ja para zh-së apo 1 para 24.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Lista do të jetë sipas prioriteteve.

Këshilltar E.Bregu: Në listën e prioriteteve duke parë seksionin për sportin shikojmë që është planifikuar rikonstruksioni i mbajtjeve të objekteve sportive, ndërtimi i stadiumit e të tjera me rradhë me një vlerë të konsiderueshme rreth 35 milion euro, ndërkohë që para pak kohësh është miratuar një kërkesë nga kryetari i bashkisë për dhënien e autorizimit për firmosjen e një kontrate për stadiumin të cilën ne nuk dimë se çfarë është bërë edhe pse ne rradhën e kaluar e pyetëm kryetarin dhe ai nuk arriti të përgjigjej për shkak se u mbyll mbledhja para kohe dhe i mbeti përgjigjia pezull. Mos ndoshta është e nevojshme të na i sqarojë tani këtë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër, vlera siç thashë janë idikative nuk është se i përkohet ndonjë prevetivi të caktuar tashmë, procesi për ndërtimin e stadiumit të ri të Korçës edhe zonës është duke ecur, aktualisht Fondi Shqiptar i Zhvillimit është duke u marrë me procedurën e hartimit të projektit përfundimtar, pasi në konkursin që u realizua u shpall projektideja fituese tani kjo projektide duhet përkthyer në një projekt zbatimi, aktualisht jemi në këtë fazë, edhe dje mos gaboj kemi pasur një omunikim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ku na janë kërkuar një sërë materialesh harta detaje të tilla që janë dërguar nga ana jonë dhe jemi duke bashkëpunuar për ta cuar para këtë proces por në këtë moment në rast se më pyesni kur do fillojnë punimet nuk jam

në gjendje të them një datë, shpresoj brenda këtij viti por nuk ju premtoj sepse është një projekt kompleks ka disa aktorë brenda vlera e financimit është e madhe.

Këshilltar E.Bregu: Domethënë i bie që është firmosur kontrata në parim pa detaje apo është firmosur me ndonjë detaj shtesë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kemi firmosur kontratë por kemi firmosur marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, me Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Teritorit dhe me Ministrinë e Arsimit secili nga këta 4 aktorë ka rolin e tij në këtë proces dhe rolin kryesor e ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Këshilltar E.Bregu: Kjo marrëveshja ka bashkëngjitur projekt, skica apo thjesht marrëveshje në parim?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nuk ka projekt sepse e shpjegova kemi projektidenë që ka dalë fituese nga konkursi dhe tani do të punohet për ta kthyer projekt në zbatim.

Këshilltar E.Bregu: Pra është vetëm në parim marrëveshja.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Marrëveshja e kemi kaluar këtu në këshill dhe ka rolin dhe detyrën e gjithsecilit prej këtyre aktorëve në finalizimin e këtij projekti.

Këshilltar D.Osmeni: Kisha një pyetje në lidhje me listën, kur themi rikonstruksioni i rrugëve i njësisive administrative ka të bëjë edhe me shtrimin e asfalteve të reja apo ato që janë ekzistuese?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të gjitha edhe shtrime e rrugëve me asfalt të cilat janë pa asfalt edhe rikonstruksion të rrugëve që janë po janë të dëmtuara, pra është vënë një vlerë në total.

Këshilltar L.Nako: Në arsimit është rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “Sevasti Qirjazi” me sa jam unë në dijeni kjo shkollë është rikonstruktuar rreth 3 ose 4 vite më parë pas pandemisë dhe e shikoj që është e vendosur këtu, mund të na jepni një shpjegim ju lutem?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër, kjo shkollë është rikonstruktuar së fundmi në vitin 2007 ose 2008 dhe para 3 vitesh është kryer një ndërhyrje e pjesshme për sa i takon termoizolimit të fasadës të shkollës dhe këto punime janë kryer në kuadrin e mirëmbajtjes që ne bëjmë për të gjithë objektet arsimore çdo vit, pra para 3 vitesh është relaizuar kjo ndërhyrje ndërkohë tani flitet për një rikonstruksion të plotë të kësaj shkolle dhe rikonstruksioni i fundit i plotë është bërë në vitin 2007-2008.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Këshilltare I.Seidolli: Kam parë fushat të cilat janë shpallur këtu proritare me zërat përkatës, do të doja që zërat të ishin më të detajuar në lidhje me ato çfarë do të bëjmë, përshembull kemi pikën 6 që thotë unifikimi i fasadave përgjatë bulevardit “Gjergj Kastrioti” dhe krahas këtyre jepen edhe vlerat por do të ishte shumë mirë të shpjegohej që ky unifikim ka të bëjë thjesht me lysterjen, ka të bëjë me veshjen kapot, ka të bëjë me suvatim apo kur në zëra të përgjithshë flasim

për rehabilitimin e rrugëve të fshatrave, domethënë bashkia e Korçës ka 62 fshatra dhe për cilat konkretisht është menduar të bëhet ky investim?

Pra kemi investime në arsim, sport, në kulturë, në shëndetësi, në projektin afatmesëm një ndër prioritetet përkrah turizmit dhe teknologjisë ishte dhe buqësia, do të doja që më konkretisht këtu të përfshiheshin përveç rehabilitimit të kanaleve dhe ujësjellësit, të shpalleheshin më konkretisht ato planifikime që janë bërë duke e konsideruar buqësinë edhe si degë prioritare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani po e filloj nga kjo e fundit lista e prioriteteve të investimeve është e hapur, në rast se ju keni një propozim konkret për ta përfshirë në këtë listë ju lutem na i thoni ta përfshijmë me shumë gatishmëri, për sa i takon zërave që janë të përgjithshëm është mënyra e vetme për ta hartuar këtë listë sepse në rast se do hartosh çdo emër të çdo rruge, të çdo fshati do na dalë ajo si lista e kordinatave topografike të vendepozitimit të mbetjeve dhe do duket fare kshu, bëhet fjalë për të gjitha rrugët e të gjitha fshatrave, është bërë një vlerësim i përafërt nga ana e zyrës se sa mund të jetë buxheti dhe më pas ne çdo vit ndërhyjmë në një grup rrugësh të caktuara kurse për pjesën e fsadave bëhet fjalë për unifikimin e fsadave ka qënë një projektide e hershme që fatkeqësisht nuk kemi patur mundësi ta realizojmë unifikim e fsadave në katin përdhe, i njëjti model që u bë tek zona këmbësore tek godina e ish Mapos kemi mundësi ta zbatojmë edhe tek bulevardi “Gjergj Kastrioti” duke i unifikuar ato fsadat por duke e bërë edhe më atraktive edhe si zonë por duke e rritur mundësitë edhe për bizneset për të rritur xhiron e tyre.

Këshilltar E.Bregu: Kisha edhe një pyetje, duke parë gjithë këto vlera 35 milion euro është vetëm stadiumi përfshirë dhe të gjitha bëhet një shumë shumë e madhe dhe duke pasur parasysh faktin që buxheti i bashkisë Korçë është rreth 22 milion euro teorikisht, me diskutimin që bëri Klajdi herën e kaluar tha që realizimi është 50% shkon 11-12 milion euro, mos ndoshta gjithë këto shpenzime na i zhbalojnë buxhetin ku do gjenden fondet?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe njëherë po flasim për një listë të prioritetit të investimeve dhe kjo listë nuk është lista e investimeve që do të realizohen këtë vit.

Këshilltar E.Bregu: 20024-2026 thotë këtu.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja ta shpjegoj edhe njëherë, prandaj e bëra shpjegimin në fillim, ne jemi të detyruar në bazë të ligjit që çdo investim që bëjmë duhet ta kemi në listën e prioritetit të investimeve dhe në këtë moment ne ose miratojmë këtë listën kështu dhe ecim pastaj ose duhet rast pas rasti të vijmë këtu në këshill të kërkojmë miratim, kjo është për lehtësimin e punës kemi një listë të përgjithshme të prioritetit të investimeve në rast se doni të shtoni diçka që mund të na ketë shpëtuar patjetër mund ta shtoni në mos sot mbledhjet e tjera dhe në bazë të kësaj liste ne shohim në varësi edhe të mundësive tona, të donatorëve të ndryshëm që vijnë, të mundësive të tjera të financimit zgjedhim se cilin projekt do të financojmë, kjo është.

Këshilltar K.Pllaha: Meqënëse u hap si diskutim kjo çështja e stadiumit dhe na thatë që Fondi Shqiptar i Zhvillimit po meret me detajet e projektit do ketë ndonjë fazë konsultimi publik me qytetarët dhe gruper e interesit për këtë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër, për këto projekte kaq të mëdha është i detyrueshëm konsultimi publik dhe vetë ai konkursi që u realizua ishte një lloj konsultimi publik, nuk besoj se pretendoj që vendimmarrja do i liheshe publikut sepse vendimmarrjen jo në Korçë, jo në Shqipëri por edhe në botë e bëjnë njerëz të specializuar për këtë pjesë, po patjetër u diskutua ishte një proces i hapur kishin mundësi ta ndiqnin dhe patjetër çfarë janë detyrime ligjore për projekte kaq të mëdha patjetër që ato do respektohen

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

### **Pika 16 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË KORÇË.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar E.Nexhipi: Është një çështje që diskutuam edhe në fillim të kësaj mbledhje, nga ekzekutivi u pa e arsyeshme të silllej një informacion shtesë, materiali i procesverbalit të konsultimit publik unë isha prezent edhe vetë në atë mbledhje, diskutimet e publikut nuk ishin në kundërshtim të këtyre propozimeve të bëra por ishin kërkesa kryesisht të ndryshimeve të tjera që ka nevojë në zona të caktuara të teritorit të bashkisë, gjithsesi tre temat e propozuara në këtë takim u mirëpritën dhe nga ekzekutivi u sqarua që ato kërkesa që nuk janë pjesë e këtij materiali do të shikohen në fazat e ardhshme të rishikimit të planit vendor, për sa i takon relacionit të propozuar kërkesa për shtesë në varrezat publike Drenovë, vend depozitimi i mbetjeve inerte dhe krijimi i njësisë të re strukturore për zhvillimin ekonomik për një subjekt prodhues në qytetin e Korçës, unë ju ftoj ti votojmë për të autorizuar ekzekutivin në ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e këtyre ndryshimeve pjesore në planin vendor.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.Nexhipi, kush e do fjalën?

Këshilltar I.Bode: Znj.Kryetare unë ju bëj thirrje ju dhe gjithë këshilltarëve vazhdoj të këmbëngul që shqyrtimi i kësaj pike në mbledhjen e këshillit është në kundërshtim me rregulloren, e kuptoj që ndoshta ka një urgjencë por nuk besoj se ka ndonjë urgjencë kaq të madhe që kjo të shtyhet për pak me qëllim që të paraqitet një material i plotë mund të bëjmë dhe një mbledhje jashtë rradhe dhe nuk besoj se nga këto tre pika që na keni paraqitur përshembull kjo e treta që është kërkesa e një biznesi nuk besoj se këtij zotërisë do i interesojë që ne të marim një vendim të gabuar sepse do investojë aty dhe ska pse të jetë mbi bazën e një vendimi që mund të ketë kundërshtim, vazhdoj të

këmbëngul që kjo pikë mos diskutohet. Në rastin se nuk do të meret parasysh dhe do të diskutohet ne si grup nuk do të marrim pjesë në këtë votim.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me këtë çështje tek pika numër 2 vend depozitimi i mbetjeve inerte mendoj se është shumë e rëndësishme përcaktimi i kordinatave dhe çfarë do ndodhë me mjedisin pasi të jenë depozituar këto mbetje dhe a ka një analizë mjedisore për këtë çështje?

Para disa vitesh është miratur një vend depozitim mbetjesh në rrezë të fshatit Barç, ish gurorja ndërkohë që inertet janë depozituar në pronë private, jo në kordinatat e përcaktuara por në kordinata të tjera, u bënë disa vite që ky fenomen ka ndodhur, banorët e zonës kanë protestuar dhe nuk është marrë asnjë masë në rastin se ne do të depozitojmë këtë vend depozitim të mbetjeve, a ka një strukturë që monitoron zbatimin e këtij vendimi por në rastin e mëparshëm çfarë ka bërë kjo strukturë për të monitoruar këtë vendim dhe zbatimin e këtij vendimi, pse e kemi ne këtë problematikë me banorët e asaj zone, kush do i dëmshpërblejë banorët e asaj zone për dëmtimin e pronës private ne dime që prona private është e shenjtë si mund tja zaptosh tjetrit në këtë mënyrë?

Kjo me një vendim të këshillit bashkiak sepse nuk ishin përcaktuar kordinatat saktë dhe nuk është monitoruar zbatimi i vendimit për depozitimin, gjithashtu dhe nuk është vendosur se çfarë do bëhet pas depozitimit të mbetjeve sepse fjala mbetje mund të duket një koncept kështu janë ca mbeturina por aty ka materiale inerte që janë tulla, asfalte të vjetra, mbetje të ndryshme të cilat e bëjnë gjithë vend grumbullimin e mbetjeve një zonë të dëmtuar që nuk shërben për asgjë, këto janë shqetësimet që ngre për këtë pikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, këshilltar tjetër?

Këshilltar D.Osmani: Për sa i përket depozitimit të mbetjeve ashtu si e parashtruan edhe problemin e këtij materiali i cili është i paplotë, ishte jo korekt që në dërgimin në këshill të këtij materiali, unë kërkoj dhe një informacion sepse ky vend depozitimi i mbetjeve që do të bëhet tek rruga e fshatit Melçan më vjen keq ta them por atje tek fshati Melçan është edhe një teqe e cila është një kult fetar dhe vizitohet jo vetëm nga besimtarët bektashinj por nga gjithë qytetarët dhe të planifikosh dhe të vendosësh që para se të shkosh tek ky kult fetar të depozitosh mbetje inerte për mua nuk është serioze është shkelje e rëndë, prandaj kjo pikë duhet të rishikohet këshilltarët duhen të informohen të kenë informacionin e saktë të mendohen para se ta votojnë secili nuk mund të mendojë politikisht mbi atë që do votojë, ju kërkoj të gjithë këshilltarëve të mendohen në këtë pike që unë e quaj sensitive.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani për sa i takon depozitimit të mbetjeve inerte, mbetjet inerte janë nga kategoritë e mbetjeve që ne i kemi pasur shumë problem historikisht në qytetin e Korçës dhe ë gjitha njësitë administrative, ju mund ti keni parë edhe vetë që janë të depozituara vend e pa vend anës rrugëve, nëpë kanale dhe ka qënë një nga përpjekjet tona që të administrojmë procesin e mbetjeve inerte dhe kjo kërkon dy elementë e para caktimin e një vend depozitimi dhe e dyta shtrëngimin e masave ndaj shkelësve të ligjit me këtë të dytën kemi ecur jemi përpjekur shumë por patjetër që duhet edhe vendi se ku do të depozitohen këto mbetje, tani ai diskutimi me kordinata po e them edhe njëherë kordinatat nuk është se mungojnë, madje ja u sollli drejtorja e urbanistikës dhe ja u vuri në dispozicion diskutimi mbi kordinatat është shumë teknik dhe nuk mund të bëhet në mbledhjet e këshillit, bëhet nga specialistët ose në komision por në rast se ju doni të bëni studimin e kordinatave jeni të lirë, ajo që ka vlerë për tu diskutuar në këshill mendoj

unë është rëndësia e kësaj pune dhe vendi ku duhet depozituar dhe njolla është e shënuar qartë në hartë se kush është zona që do depozitohen, tani po vij tek pika që ngriti këshilltari Osmani nuk është se vendi ku do të depozitohen inertet ishte një lëndinë shumë e bukur dhe ne po propozojmë ta kthejmë në vend depozitimin e inerteve, ishte një gurore që kishte mbaruar shfrytëzimin e saj, pra nuk ishte një pamje e bukur në afërsi të një objekti kulti shumë të rëndësishëm për të cilën kam shumë respekt për Teqen e Melçanit por ishte një ish gurore një grupë domethënë e cila do të mbushet me mbetje inerte dhe me pas do të rehabilitohen.

Këshilltar D.Osmani: Po opinioni i drejtuesve të asaj teqeje është marrë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ta mbaroj sepse jam duke folur, pra është një gurore pronë shteti e cila do të mbushet nga këto inerte dhe do të rehabilitohet pastaj, për pjesën e impaktit në mjedis ky projekt ka marrë edhe pjesën e vlerësimit të ndikimit në mjedis ai është akti që tregon se ky projekt është në përputhje me rregullat, me menaxhimin është menduar që të ketë një punojës atje që të kujdeset që këto mbetje të shakrohen brenda teritorit të planifikuar për këtë gjë dhe jo në afërsi të tij.

Këshilltar D.Osmani: Pyetja ishte ju si bashki keni marrë informacion apo i keni pyetur këta drejtuesit e Teqes të Melçanit?

Duke qënë një kult fetar prandaj po e cilësoj sepse po cojmë inerte nuk po ju bëjmë lulishte as rrugë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ne i kemi të përcaktuara në ligj se kë kemi detyrim të pyesim për një projekt të caktuar, në rast se ju na demonstroni se kemi shmangur dikë që duhet ta pyesim mund të na e thoni, për procesin mund të flasë pak drejtorja e urbanistikës ose drejtorja juridike se çfarë kemi pasur detyrim të pyesim dhe e kemi pyetur ose jo.

Këshilltar D.Osmani: Por besoj se ju si kryetar e keni këtë të drejtë që të pyesni, edhe njëherë nuk po ndërton përball shtëpisë time dhe të vish të më pyesësh mua sepse jam një qytetar i thjeshtë, prandaj po e theksoj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Drejtoria e urbanistikës ju lutem.

Drejtoresha e Urbanistikës Zh.Lubonja: Fillimisht për këtë vend depozitimi është marrë miratimi në parim i këshillit të bashkisë dhe me vendim numër 24 të vitit 2020 është miratuar në parim si vend depozitim dhe pastaj kemi ndjekur të gjitha hapat ligjorë që parashikon ligji për mbetjet inerte, kemi hartuar vnm-në, e kemi kaluar në agjensia e mjedisit.

Këshilltar D.Osmani: Tani ky vendimi që është miratuar në vitin 2020 është miratuar nga ai këshilli një partiak?

Këshilltar E.Nexhipi: Ai këshilli ligjor që ishte tani kot flasim jo një partiak jo gjysëm partiak .

Këshilltar D.Osmani: Po mirë pra se po e tjetërsoni po e bëni shumë të cekët këtë diskutim, ja kaluat drejtoreshës por unë po e kërkoj nga ju.

Ju si kryetar dhe ne si këshilltarë ndjejmë pak seriozitet që këtë komunitet apo çdo komunitet tjetër që bëhet fjalë ndjejmë ndonjë përgjegjësi politike edhe qytetare, prandaj po i pyes dhe këshilltarët e tjerë para se ta votojnë?

Para rrugës hyrëse sepse ne të gjithë e dimë se ku ndodhet edhe gurorja edhe Teqeja e Melçanit të shkosh dhe të depozitosh mbetje për mua kjo është ajo që duhet vlerësuar, duhen pyetur dhe duhen respektuar zotërinjtë e nderuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Devi dhe ju lutem mos ndërhyri të mbarojë folësja dhe pastaj mund të flisni përsëri.

Drejtoresha e Urbanistikës Zh.Lubonja: Mbetjet inerte nuk janë ndotjet urbane që kanë ndotje të madhe në terren, ky vend depozitimi është për të përmirësuar mjedisin në këtë zonë dhe jo për ta prishur pasi ato gropa duken edhe nga fotografia ajrore që ju kemi bashkëngjitur në material që duken që janë gropa shumë të mëdha dhe dëmtim shumë i madh në terren dhe duke e mbushur me inerte dhe pasi të përfundojë mbushja, do mbushet me dhe të mirë që të mbillet me gjelbërim, prandaj kjo vetëm përmirësim i sjell zonës.

Këshilltar D.Osmani: Ka afat ligjor kjo se kur do të mbushet?

Drejtoresha e Urbanistikës Zh.Lubonja: Afat ligjor nuk ka, sepse varet nga inertet që do të dalin çdo vit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për Z.Nexhipi.

Këshilltar D.Osmani: Shpjegimi ishte për mua.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do të jap fjalën përsëri por dëgjo.

Këshilltar E.Nexhipi: Meqënëse e tha Z.Osmani le ta vazhdojë.

Këshilltar E.Bregu: Ne jemi në kuadrin e pyetjeve, Erjoni ka pyetje?

Këshilltar D.Osmani: Pyetja ime ka të bëjë me është pyetur komuniteti apo jo, sepse as po e ngre politikisht as po e bëj që dikush të dalë këtu edhe të bëjë partizanin, thjesht kërkoj është pyetur komuniteti për këtë çështje që po i cohen inerte, është pyetur apo jo? Nëqoftëse nuk është pyetur mos e votojnë, të pyeten të bëhet një projektvendim edhe unë nuk di nëse janë apo jo dakort dhe të vazhdohet.

Drejtoresha e Urbanistikës Zh.Lubonja: Ne i pyetëm banorët.

Këshilltar D.Osmani: Me komunitetin zonjë, si çdo kult fetar ka një drejtues tani unë po pyes me komunitetin meqënëse atje është një rrugë që shkohet për tek Teqeja e Melçanit është pyetur babai i Teqes më shqip, janë pyetur ata drejtuesit e tjerë të kësaj Teqeje për depozitimin e këtyre inerteve po apo jo, jo po më thoni nuk janë pyetur, qytetarë dhe dëgjues të tjerë këtu mund të kishte janë 76 mund të ishin dhe 176 nuk ka rëndësi, po i kërkoj gjithë këshillit meqënëse



znj.kryetare dhe kryetari do ta kalojë me patjetër këtë sot po ju them mos e kalojmë sot të pyeten mund ta votojmë prapë pro mund të jetë edhe e mirë edhe për ata, të shtyhet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ligji e parashikon se kush janë hapat që ndiqen për të miratuar një projekt të tillë dhe njëri nga hapat është edhe konsultimi publik që është bërë.

Këshilltar E.Bregu: Kur është bërë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po tani datën do ja u thotë drejtoresha.

Këshilltar E.Bregu: Ja ku e keni dhe konsultimin publik, fallcivitet i gjërë, të ta ve në dispozicion.

Këshilltare I.Seidolli: Të shtrohet në formë pyetje kush na këshilltarët e ps-së ka qënë pjesë e këtij konsultimi që asnjëri nga ne nuk qenka?

Këshilltar E.Bregu: Lexoje konsultimin, për atë konsultim na thua që kanë qënë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja ta mbaroj deri në fund se mbase sqarohesh, z.Osmani është e përcaktuar sesi bëhen njoftimet për konsultime publike nuk shkojmë dhe i trokasim secilit në derë.

Këshilltar D.Osmani: Ka dhe grupe interesi që pyeten.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të mbaroj pra sepse e shikoj që e ke si kalë betejë këtë gjë.

Këshilltar E.Bregu: E ke gabim, nuk e kemi kalë betejë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të mbaroj njëherë, pra është e përcaktuar si bëhet njoftimi për konsultim publik na i tregoi drejtoresha si e kanë bërë konsultoheni dhe ligjin si është dhe shikoheni ne e kemi bërë njoftimin kush ka qënë i interesuar ka qënë kush nuk ka qënë nuk ka erdhur nuk i marrim njerëzit me zor.

Këshilltar E.Bregu: Ku ta gjejmë njoftimin?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Duhet të kërkosh të ndjekësh.

Këshilltar E.Bregu: Këshilli njoftohet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për sa i takon impaktiti, impakti në përfundim do të jetë pozitiv sepse do të rigjenerohet ajo zonë e cila ishte e dëmtuar për shkak të të qënurit shumë vite një gurore, do mbushet dhe do rehabilitohet kjo është në finale kaq.

Këshilltare I.Seidolli: Pse nuk jemi në dijeni ne për këtë takim?

Këshilltar D.Osmani: Të jemi pak më seriozë, nuk është çështje se e keq interpreton dhe pjesën e pikëve po ta them shumë sinjerisht këtu është një grup interesi një përfaqësim fetar i cili drejt rrugës ku shkohet do të depozitohen disa mbetje, ata mund të jenë shumë dakort nuk po them i kam pyetur dhe nuk janë dakort dhe po të sjell zërin e tyre këtu, të lutem para se ta miratosh ti pyesësh këtu nuk ka as politikë as pikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për sygjerimin, fjala për Z.Nexhipi meqënëse ja ndërpreme fjalën.

Këshilltar E.Nexhipi: Tani unë e kuptoj që ne këtu persona politikë jemi dhe politikë do bëjmë pa diskutim por të flasim u pyet nuk u pyet babai mua me duket që është pak dhe fyerje për vetë babain.

Këshilltar E.Bregu: Shiko ne jemi në fazën që po bëjmë pyetje nuk jemi në fazën e diskutimeve, ju lutem.

Këshilltar E.Nexhipi: Të lutem mos më ndërprit se nuk të ndërpreva.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Bëre së bashku me pyetjen edhe komente.

Këshilltar E.Bregu: Po komentet në funksion të pyetjes i bëra.

Këshilltar E.Nexhipi: Kam një pyetje për kryetarin e bashkisë, aktualisht ai teritor është i monitoruar i menaxhuar?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nga ana e bashkisë jo, po flasim në situatën që nuk do të jetë vend depozitimi, ka bashkia detyrimin që ta monitorojë si teritor?

Drejtoresha e Urbanistikës Zh.Lubonja: Jo.

Këshilltar E.Nexhipi: Pra jemi në kushtet që kemi një vend që ka degraduar nga ana mjedisore, është shfrytëzuar maksimalisht si karrierë guroreje dhe po themi ta vendosim në një proces që të paktën të jetë i monitoruar sepse aktualisht atje mund të hidhen mbetje dhe nuk monitorohet po themi si ta bëjmë detyrim ligjor për bashkinë që të kujdeset për atë teritor, po themi si ta rehabilitojmë dhe rehabilitimi i karierave është duke i mbushur, nuk po themi të cojmë mbeturina urbane, nuk po themi të krijojmë atë fushën e mbetjeve të famshme që kishim pranë Korçës, po themi një vend të disiplinuar ku do të hidhen mbetjet inerte që janë nga ndërtimet në Korçë që do të thotë gërmimet e gropave, ato materialet që janë të pa përdorshme nga ndërtimet, nuk po them për tullat apo për hekurin, po flas për ato materiale që duhen për të mbushur atë vend që në të ardhmen sipas kohës të mbushjes që mund të jetë dhe për 2 por maksimalisht është për 10 do të kemi një vend të rehabilituar nga ajo pamje që ne shohim tani në foto ose e kemi parë kur kemi vizituar teqenë të jetë një vend i rehabilituar, për mua duhet votuar.

Këshilltar E.Bregu: Po nuk kemi kaluar në diskutim jemi në pyetjet akoma, ti kërkove fjalën për pyetje jo për diskutim apo thirrje për votim, të mbarojmë me pyetjet ju lutem.

Këshilltar E.Nexhipi: Vazhdoni.

Këshilltar I.Bode: Atëherë unë shoh që po diskutojmë disa gjëra që i takojnë diskutimit si pikë, unë kam një propozim meqënëse kjo konsiderohet urgjente me sa shoh e bëjmë të enjten tjetër në një mbledhje jashtë rradhe dhe gjatë kësaj kohe ekzekutivi të përgatisë materialin ashtu siç duhet me të gjitha pikat që kërkuam edhe ne si grup opozitar dhe e thërrisim një mbledhje jashtë rradhe do të jemi shumë të gatshëm të marim pjesë në atë mbledhje të diskutojmë dhe pse jo dhe ta votojmë, nuk është se ne nuk bihem dakort të diskutojmë këto ndryshime çështja është fare e thjeshtë, kjo pikë bie sepse gjithë materiali i paraqitur nuk ka qënë në bazë të rregullores, nuk ka lidhje as me çështje teknike, as me kordinata, ka lidhje me ligjshmërinë për sa kohë që jemi duke u mbështetur tek ligjshmëria dhe themi se këto vendime meren duke bërë dëgjesa publike se dhe me këtë dëgjësën që qënka bërë 10 ditë para ne nuk kemi një njoftim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E keni tek faqja e web-it.

Këshilltar I.Bode: Mbase mund të jetë, nuk e ve në dyshim që ato pika siç i parashikon ligji janë respektuar deri këtu nuk janë respektuar më tutje, ky material ka qënë i mangët që kur na është dërguar zyrtarisht me email verifikoheni dhe do të shihni që në relacionin lidhur me këtë pikë ka vetëm një hartë atje dhe asgjë tjetër, nuk ka ndonjë gjë e bëjmë të enjte një mbledhje jashtë radhe dhe mbaron historia, faleminderit.

Këshilltar K.Pllaha: Besoj se duhet ti jepni përgjigje kësaj kërkesës që bëri Z.Bode.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pyetje për kryetarin njëherë.

Këshilltar K.Pllaha: Po por nëqoftëse i jepni përgjigje kësaj mbase do ishte e pa vlerë pyetja ime por gjithsesi po e bëj, së pari janë tre ndryshime dhe duhen marë secila me rradhë sepse dhe në votim nuk mund të jemi dakort apo kundër me të treja pikat, së dyti meqënëse e nisëm nga çështja e konsultimit publik për zonën e mbetjeve e inerteve, konsultimi publik në këto raste bëhet tek vendi që ku kërkohen ndryshimet e planit urbanistik jo tek zyrat e bashkisë meqënëse jemi tek ligjshmëria plus njoftimi publik me afatet kohore së dyti diskutimi është dhe politik sepse jo më kot jemi ulur në anën e djathtë dhe e mbajmë si pronë private të shenjtë ne nuk e kemi si informacion dhe shoh këto ndryshimet që po bëhen janë në pronë private apo publike për guroren e kuptova që është pronë publike, po shtesa që po bëhet tek varrezat e Drenovës është pronë publike apo private?

Përsa i përket pikës të tretë nëqoftëse është pronë private atëherë duhet bërë dhe shpronësimi?

Drejtoresha e Urbanistikës Zh.Lubonja: Është pronë private.

Këshilltar K.Pllaha: Atëherë meqënëse qenka pronë private besoj duhet një dakortësi edhe nga banorët edhe nga pronarët nuk po them se është detyrim ligjor por të paktën edhe një konsultim publik duhet bërë dhe për pikën e tretë megjithëse unë jam i djathtë dhe e vlerësoj energjinë individuale për zhvillimin e motorit ekonomik, kisha një pyetje që mjafton vetëm një kërkesë nga një biznesi apo individ për ndryshimet e një plani urbanistik sepse pastaj krijojnë precedentë apo jo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër pjesa e gurores që propozohet të kthehet në vend depozitimin e inerteve është pronë publike, pjesa e varrezave të fshatit Drenovë është pronë private është diskutuar me pronarët janë dakort që të shpronësohet për të shpronësohet duhet të meret ky vendimi në këshill dhe të ndiqet procedura pjesa e kësaj shtesës të fabrikës është pronë private e subjektit që e ka marrë fabrikën.

Këshilltar K.Pllaha: Kur e ka marrë pronësimin?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kush është qëllimi i pyetjes?

Këshilltar K.Pllaha: Qëllimi i pyetjes është unë e vlerësoj që ka investitorë që investojnë dhe ka vende pune qëllimi i pyetjes ishte ky nëqoftëse kjo pronë është blerë së fundmi me çmimin e tokës buqësore nëqoftëse është blerë vite përpara ok por me ndryshimin e destinacionit ajo merr vlerë tjetër prandaj qëndron pyetja se kur është marrë titulli i pronësisë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo:Tani po sqaroj edhe atë pyetjen tjetër në rast se çdo kërkesë që na vjen ne e përfshijmë në propozim për ndryshim plani apo jo, jo nuk i përfshijmë mund të vijnë shumë kërkesa po ato filtrohen nga ana e zyrës dhe ato që ne i gjykojmë se janë në rregull edhe me ligjin edhe me prespektivën zhvillimore ja u paraqesim ju për ndryshim të planit, pastaj pyetja tjetër kur e ka blerë këtë pronë nuk e kam informacionin, duhet marrë në hipotekë sepse unë logjikën e pyetjes e kuptoj por çfarë duhet të bënte zotëria duhet të bënte njëherë tjetërsimin në plan pastaj ta blinte?

Këshilltar K.Pllaha: Unë bëra një pyetje dhe nuk mora përgjigje, tani duhet të jap përgjigje?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë tu përgjigja, është e sigurt ai e ka blerë sepse dhe sot që flasim është tokë buqësore pra ai e ka blerë në momentin që ajo tokë është tokë buqësore dhe çfarë duhet të ndodhë tani përshembull?

Këshilltar K.Pllaha: Nuk është fare çështje personale investitore në fjalë në të ardhmen mund të kemi çështje të tjera të ngjashme që bashkia Korçë ka një plan strukturor që e di vetëm ekzekutivi që do bëjë ndryshime të planit urbanistik dhe ata që kanë informacion e marini tokën me një çmim të ulët si tokë buqësore dhe më pas duke ndryshuar planin i rritet vlera në mënyrë eksponenciale pra e kupton qëllimin e pyetjes?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë këtë e kuptoj dhe kjo teorikisht mund të ndodhë prandaj dhe procesi i ndryshimi të planit rregullues nuk bëhet nga drejtoria e urbanistikës apo nga kryetari është një proces shumë i gjatë i cili kjo që po bëjmë ne sot i kanë paraprirë ca hallka më përpara përfshirë edhe dëgjuesin publike dhe miratimin nga zyra do miratohet në këshill do shkojë në AKPT do qarkullojë edhe në disa ministri dhe pastaj do miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe ndryshimi i planit rregullues të çdo bashkie bëhet me vendim të KKT-së dhe më vjen shumë keq që nga ana jote që je dhe me filozofi dhe me qasje të djathtë në suport të biznesit për një rast konkret bën një situatë që ky e ka blerë tokë buke me vlerën e tokës të bukës.

Këshilltar K.Pllaha: Më vjen keq unë e theksova që në fillim të fjalës time që unë e mbështes zhvillimin e biznesit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal edhe diçka të vogël mua për pak më duhet të leviz sepse kam një takim shumë të rëndësishëm online, në rast se ka ndonjë pyetje shumë të rëndësishme për mua do ju lutesha të ma bënit tani kam vetëm dy minuta kohë.

Këshilltar E.Bregu: Kam pyetje për kryetarin dhe një propozim meqënëse kryetari do lëvizë, në lidhje me vend depozitimin meqënëse ka qënë gurore dhe është shfrytëzuar sipas ligjit ai që e ka shfrytëzuar duhet ta kishte rehabilituar, ka marrë kryetari në konsideratë këtë çështje?

E dyta për konsultimin publik të gjithë që kanë firmosur këtu janë punojës të bashkisë, administratorë që varen nga bashkia dhe një pjesë e anëtarëve të këshillit bashkiak këtu janë të gjithë vartës të kryetarit të bashkisë, ky është konstatim që ka nevojë për pyetje, e quan konsultim këtë Z.Kryetar?

Kam një propozim pas pyetjeve meqënëse kryetari po largohet ne nuk kemi pse vazhdojmë mbledhjen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo është mbledhja e këshillit nuk është mbledhja e kryetarit.

Këshilltar E.Bregu: Kush e ka thirur këtë mbledhje?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mbledhjen e ka thirur kryetari.

Këshilltar E.Bregu: Pse vjen këtu ti, mos hajde fare atëherë, ke erdhur të rrih këtu, të doli punë unë mendoj ta ndëpresim mbledhjen mbaj proceverbal dhe ta vazhdojmë nesër. Ti thua unë e bëj por skam pse marr pjesë atëherë pse ke erdhur?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mos qesh sepse nuk ka ndonjë situatë për të qeshur po qesh me gjërat që thua vetë.

Këshilltar E.Bregu: Po qesh me situatën sepse e ktheni ju qesharake, po qesh me gjërat që bën ti.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani po merem me pjesën serioze të fjalës tënde që ishte pyetja, në çdo proces konsultimi apo dëgjese publike detyra e bashkisë është të bëjë njoftimin sipas përcaktimit të ligjit në stendën e bashkisë, në website i bashkisë dhe në rast se njerëzit nuk paraqiten ne nuk i marrim me zor.

Këshilltar E.Bregu: Dhe për vend depozitimin e mëparshën nuk na ktheve përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem tani se po flet tjetri.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mbledhjen tjetër.

Këshilltar E.Bregu: Po si mbledhjen tjetër nuk është kjo çështje.

Këshilltar E.Fejzullah: Për sa i përket vend depozitimit, nëqoftëse ky vend depozitim do të bëhet atje a do të sjellë a do të ketë të ardhurat siç kanë vend depozitimet e tjera që menaxhohet me të ardhurat që vijnë nga ata që depozitojnë këto mbetje, pra do ketë një strategji të tillë apo do jetë i menaxhuar nga bashkia?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër që ka kosto operacionale për ta menaxhuar ne kemi miratuar në këshillin e bashkisë një tarifë për mbetjet inerte dhe në çdo leje ndërtimi krahas taksave dhe tarifave të tjera mbajmë edhe këtë tarifën në varësi të volumeve që llogariten nga prevetivat që subjektet paraqesin për rastet e mbetjeve individuale jo të një leje ndërtimi do kemi një person që do të mbajë një tarifë në vendin e depozitimit. Tani unë ju kërkoj shumë ndjesë por unë duhet të largohem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Z.Kryetar për prezencën, ju lutem këshilltarëve vazhdojmë, së pari më vjen mirë që edhe pse nuk keni dashur që pika 16 të futet në rendin e ditës më vjen mirë që keni qënë shumë aktivë për të diskutuar, për të bërë pyetje unë mendoj se neqoftëse është ezauruar dhe nuk ka ndonjë këshilltar tjetër për të bërë koment ta hedh në votim.

Këshilltar E.Bregu: Ne bëmë një propozim meqënëse kryetari u largua nga mbledhja a ndërpritet mbledhja?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk ndërpritet mbledhja, mbledhja është e jona.

Këshilltar I.Bode: Unë në emër të grupit të opozitës bëra një propozim hidheni poshtë pra .

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort nga këshilltarët që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 10

Vota KUNDËR 16

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk do të ketë një mbledhje të dytë, atëherë do e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

**Pika 17 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E VEND DEPOZITIMIT TË MBETJEVE INERTE.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni meqënëse është në vazhdim të kësaj.

Këshilltar E.Nexhipi: Tani para se të filloj kam një koment të vogël të marësh pjesë në diskutim dhe mos marësh pjesë në votim më duket pak si pa sens, megjithatë secili ka mendimin e vet.

Këshilltar I.Bode: Z.Nexhipi ju mund ta shtroni si të doni çështjen mos pjesmarrja në votim nuk do të thotë që ne nuk morëm pjesë në diskutim ju dëgjuat që ne këmbngulëm që kjo pikë të diskutohet siç duhet sapo votuat një pikë që bie në kundërshtim me rregulloren.

Këshilltar E.Bregu: Këshilltari ka të drejtë para votimit të deklarojë që të mbahet procesverbal që nuk mer pjesë në votim ky është citimi meqënëse e do me numër do ta them dhe numrin.

Këshilltar E.Nexhipi: Në vazhdimësi të asaj që diskutuam vjen propozimi për vend depozitimin e mbetjeve inerte, komisioni e shqyrtoi materialin dhe ja propozon këshillit të bashkisë për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse kjo pikë u diskutua dhe është në vijim të asaj që miratuam pak më parë e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

### **Pika 18 e rendit të ditës.**

SIPAS KËRKESË TË SHOQËRISË "KORÇA 2008 ".SH.A. PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË;

- PËR EMËRIMIN E AUDITUESIT LIGJOR, PËR AUDITMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2023 TË SHOQËRISË "KORÇA 2008" SH.A.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Atëherë me kërkesën e datës 13.02.2024 të Asamblesë Të Përgjithshme Të Aksionerëve të Korça 2008 lidhur me emërimin e audituesve ligjorë për pasqyrat financiare për vitin 2023, bashkia e Korçës i kërkon këshillit të bashkisë të bëjë emërimet përkatëse të audituesve ligjorë, grupi i këshilltarëve socialiste ka dy propozime për Znj.Ilda Ikonomi dhe Znj.Anila Çunoti ju ftoj që ti votojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka propozim tjetër nga këshilltarët?

Këshilltare A.Zheku: Duke mbështetur dy kandidaturat e parafolësit nuk mendoj se duhen përjashtuar edhe audituesit ligjorë të tjerë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun e Korçës, në

dijeninë time janë 5 auditues të lincësuar dhe përveç Ildës dhe Anilës të çertifikuar në 2008 është dhe Etleva është dhe zonja e nderuar Silvana Cifligari e çertifikuar në 2012 dhe zoti Vasil Xega i çertifikuar në 2020 unë propozoj ta hedh të gjithën në votim dhe votimi duhet të jetë i fshehtë për mendimin tim për të ruajtur konfidencialitetin e votimit dhe dy që do mbledhin vota më tepër të miratohen.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë me sa kuptova ju propozoni edhe tre të tjerë?

Këshilltare A.Zheku: Shtoj dhe tre të tjerë meqenëse numri është relativisht i vogël.

Këshilltar e.Nexhipi: Për procedurë e para duhet të kalojmë si mbledhje e asamblesë duhet ta cilësojmë që të dalë në procesverbal e dyta mund të funksionojë dhe kështu të marim listën por duhet të kemi një komunikim paraprak me ta sepse mund të jenë të ngarkuar dhe ne e miratojmë dhe ata nuk pranojnë, Etleva me sa di unë me ndërrmarjet që janë pronë e këshillit bashkiak ka kontrata ka dhe afate ligjore se sa herë në vit ripërtërihet.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Doja të shtoja që votimi i fshehtë në këshill duhet bërë me kërkesë të jo më pak se një të tretë anëtarëve të tij dhe në bazë të kërkesës këshilli mer vendimin nëse duhet bërë apo jo i fshehtë.

Këshilltar E.Bregu: Nëqoftëse bëhet fjalë që po e hedhim në votim këta dy persona po e mar situatën në tërësi sipas rastit konkret i bie që është biseduar me këta persona dhe këta kanë rënë dakort dhe ne vetëm i miratojmë ose jo?

Mos ndoshta do ishte me vend që ne të ishim informuar dhe të sillnim propozime për të tjerë të cilët ne kishim biseduar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po e kisha në rendin e ditës mund ta bëje.

Së pari duhet të biem dakort të votohet nëse do të bëhet votimi i hapur apo i fshehtë dhe pastaj një e treta ka të drejtë të shprehet.

Këshilltare A.Zheku: Herën e kaluar prapë kemi bërë të njëjtin diskutim, a është marrë miratimi i dy ose ndodhi e kundërta ishte marrë miratimi e njëjës prej zonjave që unë propozova.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të treja kishin shprehur vullnetin.

Këshilltar P.Tollkuci: Duke qënë se kolegja e tha se ne e kemi pasur një votim një seancë përpara unë nuk e gjykoj që nga një votim që e kryhem herën e kaluar i hapur të kalojmë në votim të fshehtë sot, nuk shikoj ndonjë arsye, gjithsesi ky është një propozim që ne nuk e dimë por hamendësojmë, sigurisht ka treg konkurrence por ne nuk e dimë si e kanë ngarkesën, kështu që për sa kohë ne na vijnë dy kandidatura që është diskutuar dhe është pranuar në parim nga ta ne e kemi në dorë që ti miatojmë ose jo.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po i hedh një nga një në votim. Kush është dakort me Znj.Anila Çunoti?



Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort me Znj.Ilda Ikonomi?

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

### **Pika 19 e rendit të ditës.**

#### **RAPORTI I MONITORIMIT JANAR-DHJETOR 2023.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ë shtë thjesht një informacion i raportiti të monitorimit nuk e di nëse këshilltarët e kanë lexuar dhe kanë nevojë për të bërë ekzekutivit ndonjë pyetje, kalojmë meqënëse nuk ka.

### **Pika 20 e rendit të ditës.**

#### **KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.**

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po ju bëj me dije se kanë erdhur në sekretarinë e këshillit një kërkesë për krijimin e një komisioni të përkohshëm drejtuar nga Z.Bregu. Të nderuar zotërinj, në bazë të rregulores të këshillit të bashkisë kërkojmë ngritjen e komisionit të përkohshëm për të kërkuar gjetjen dhe rekomandimet, detyrat e lëna të KLSH-së për kontrollin e kryer sipas raportit të KLSH-së të vitit 2022 afati i funksionimit të komisionit të jetë 6 muaj baza ligjore, neni 45 dhe në vazhdim i rregullores të këshillit të bashkisë Korçë, neni 45 komisionet e përkoshme krijohen nga këshilli për një çështje të caktuar, këshilli miraton me vendimin emrin, qëllimin apo kopetencat dhe afatin ligjor të funksionimit të tij dhe përbërje e tij dhe zgjedh krytarin e komisionit duke respektuar në përbërjen të tyre të raportit forcave politike në këshill si dhe barazinë gjinore mënyra e krijimit dhe funksionimit të komisioneve të përkohshëm bëhet njësoj si me komisionin e përhershëm, duke ju falenderuar për bashkëpunimin. Në dijenin time sepse ne jemi interesuar për të marrë një informacion në lidhje me raportin përfundimtar e KLSH-së ju kërkoni për të audituar në lidhje me raportin e auditit të vitit 2022, ju duhet ti referoheni cilës periudhë do të auditohen.

Këshilltar E.Bregu: Periudhës 18 mujore.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ju kemi kthyer një përgjigje zyrtare lidhur me këtë dhe është kuptuar sikur ju doni kontrollin e vitit 2022 dhe kontrolli për vitin 2022 nuk ka përfunduar akoma.

Këshilltar E.Bregu: Ne kemi kërkuar aty jo periudhën e auditimit por datën ose vitin kur është raportuar raporti nga KLSH e kemi cituar saktë gjithsesi nëqoftëse është e nevojshme ne do ta bëjmë një korigjim nuk është problem, ne kemi mbështetjen e pothuajse gjithë grupit opozitar për ta vënë në funksion e kemi konsideruar ngritjen e këtij komisioni si një ndihmesë dhe për kryetarin e bashkisë sepse ai nuk ka një instrument që mund ta kontrollojë këtë dhe ne me këtë ndihmesë ndihmojmë kryetarin e bashkisë sepse ndoshta administrata e tij mund të ketë çeduar në ushtrimin e detyrave, për këtë arsye bazuar në rregulloren e këshillit i kërkoj konsensus dhe grupit të këshilltarëve socialiste Z.Petrika Tolluci që ta diskutojnë dhe rradhën tjetër komisionet ta shqyrtojnë procedurën dhe të ndjekim hapat e nevojshëm proceduriale bazuar në rregulloren e këshillit sipas raporteve që shumicën e ka pozita dhe pjesën tjetër opozita dhe drejtimin e një komisioni i takon opozitës.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Qëllimi është që të shikoni nëse ne i kemi zbatuar rekomandimet e KLSH-së, këtë mund ta u japim ne nuk është nevoja të ngrini komision.

Këshilltar E.Bregu: Ne i kemi kërkuar por ju nuk keni pasur mundësi të na i sillni.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Zbatimi i kontrolleve të KLSH-së është kontrolluar njëherë nga vetë KLSH nëse i kemi zbatuar apo jo dhe pastaj nëse konstaton që nuk i kemi zbatuar ka dhe mekanizma të tjera.

Këshilltar E.Bregu: Me këtë diskutim po më thua që e kemi të gabuar kërkesën?

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Po patjetër ne jemi audituar nga auditi i jashtëm, auditi ka dalë me një raport ne kemi marrë përsipër se çfarë do zbatohet nga ai raport dhe auditi ka erdhur përsëri për ti parë nëse i kemi zbatuar ato që kemi marrë përsipër apo jo.

Këshilltar E.Bregu: Nëse ju i keni zbatuar ne do ju japim nga një fletë lavdërimi.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ato që nxjer KLSH janë rekomandime, në bazë të rekomandimeve të KLSH-së del një urdhër i kryetarit të bashkisë në lidhje me ato që do të zbatohen nga rekomandimet dhe gjithcka që është në urdhër të kryetarit të bashkisë zbatohet.

Këshilltar E.Bregu: Rekomandimet janë të detyrueshme apo jo ?

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Rekomandimet jo.

Këshilltar E.Bregu: Prandaj ne mendojmë ta ndihmojmë kryetarin e bashkisë me këtë çështje, tani bazuar në rregulloren e këshillit të bashkisë kemi paraqitur disa firma që mbështesim kërkesën, kërkesa është e ligjshme dhe sipas kësaj kjo kërkesë mendoj të futet në mbledhjen e rradhës ta shqyrtojë komisioni përkatës, kryesia e këshillit dhe më pas të na sygjerojnë se çfarë

hapa duhen ndjekur dhe nëqoftëse e kemi gabim duhen shtesa ose ndryshime të shohim se çfarë mund të bëjmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për sygjerimin, gjithashtu ka erdhur një kërkesë që ka të bëjë në lidhje me bursat nëse ju kujtohen janë gjithë ata ajo kategori nxënësish prindërit e të cilëve marrin ndihmë ekonomike dhe të cilët nuk futen në kushtet e përfitimit, ju lutem ekzekutivi në lidhje me këtë.

Ekzekutivi S.Zguri: Për sa i përket kriterit ekonomik është marrë pika 2.1 gërma c që do të thotë pamundësi financiare dhe pamundësi financiare do të thotë pa ndihmë ekonomike për të dy prindërit, pa ndihmë ekonomike me dokumentacion nga drejtoria e kujdesit social dhe që janë punë kerkues të papunë dhe në total dua të theksoj 123 janë të kriterit ekonomik, në total janë 498 përfitues nga 370 që mbështeten nga ministria e arsimit dhe 148 do mbështeten nga buxheti i miratuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është një kërkesë nga kryetari i bashkisë drejtuar drejtorisë të strehimit dhe menaxhimit të banesave sociale ku kërkohej informacion i plotë në lidhje me përfitimin e zonjës që po pret këtu për të marrë një përgjigje, drejtoria ka bërë një material të plotë në lidhje me këtë informacion për këshillin i është drejtuar komisionit të strehimit dhe në emër të komisionit do i japë fjalën Edës.

Këshilltari E.Mitre: Siç e tha dhe kryetarja kjo është përgjigje e detyrës të lënë nga kryetari mbledhjen e kaluar, znj.Mirela si drejtoreshë e strehimit ka sjellë dokumentacionin e nevojshëm, unë në emër të komisionit e kam parë me shumë vëmendje, është protokolluar çdo gjë që është thënë në mbledhje, janë bërë të gjitha lëvizjet ato që duhen sipas pikëve të përfituara sipas kritereve të përcaktuara me ligj, është një komision i përbërë që atë ditë kanë marrë pjesë 10 anëtarë që nuk janë pak është shumica e komisionit të gjithë kanë firmosur për këto ndryshime, gjithashtu znj.Mirela na ka vënë në dispozicion edhe fletët vlerësuese të anëtarëve që kemi në trajtim, unë nuk shikoj ndonjë shkelje deri tani të të subvencionimit të interesave të kredisë, mendoj se çdo gjë është në rregull deri tani.

Qyetetarja: Djali im është i sëmurë dhe jeton në myk kur i kam shkuar drejtoreshës në zyrë ajo me ka thirrur dhe nuk më ka sqaruar siç duhet se çfarë kritere duhet të plotësoj që të kaloj në një banesë tjetër, mund të vini dhe ju ta shikoni që shtëpia është me myk dhe kushtet janë të papërshtatshme, familjen në katin e tretë e hodhi në zgjerim kurse mua më ka ulur pikë sepse ata nuk janë asnjëri të punësuar ku i gjetën pikët?

Këshilltari E.Mitre: Në fletën tënde të pikëzimit janë 24 pikë, sa pike të ka ulur?

Qyetetarja: 5 pikë.

Këshilltari E.Mitre: Po këtu gjithsej janë 28 pikë si të ka ulur 5 pikë, ku të janë ulur pikët?

Qyetetarja: Ajo e di ku mi ka ulur.

Këshilltari E.Mitre: Po si mund të ulë pikët drejtoresha kur ka një komision?

Kur dokumentacioni është në rregull ne nuk kemi çfarë të flasim më shumë se kaq.

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse bëhet fjalë për disa dosje, unë mendoj që ato dosje ti shikojnë me imtësi se çfarë dokumenta kanë që dhe qytetarja të marrë një përgjigje dhe të mbyllet ky debat.

Këshilltare E.Mitre: I ka vënë Mirela në dispozicion mund ti shikoni.

Këshilltar E.Bregu: Dokumentat ku bazohet pikëzimi meqënëse qytetarja pretendon se janë bërë ndryshime.

Këshilltare E.Mitre: E ke në pikëzim edhe djalin me aftësi të kufizuar, me fal që po ta përmend.

Këshilltar E.Nexhipi: Ju lutem kujdes me të dhënat që përdorni në publik sepse për dikë nuk është problem por për dike tjetër mund të jetë dhe kujdes kush do jetë pjesë e komisionit të meret një deklaratë që mos nxiren këto të dhëna pasi mund të jenë shumë të ndjeshme.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po i jap fjalën drejtoreshës.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Tani në lidhje me transparencën e shqyrtimit të kërkesës të familjes Dyli nga kryetari i bashkisë na u la një kërkesë që ne duhet tja vinim këshillit në dispozicion gjithë dokumentacionin bashkëngjitur ne ju dërguam formularin e kritereve të pikëzimit kjo bëhet për të respektuar dokumentacionin që është një dokumentacion konfidencial dhe ne nuk mundemi dosjen e aplikantëve ta sjellim sepse duhet të ruajmë të dhënat, mar shkas nga ankesa e zonjës që thotë me janë hequr pikët unë e kam para formularin dhe vlerësimi bëhet nga zyra jonë. Zonja ka bërë aplikimin ka kërkuar zgjeim dhe ka plotësuar dokumentacionin që lidhet me kushtet e strehimit sipas të cilit nuk disponon banesë në pronësi këtu ka fituar 6 pikë.

Këshilltar E.Bregu: Sa është maksimumi atje?

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: 6 pikë ka fituar, në kushtet e strehimit ka dhe pika të tjera sepse ka familje që mund të përmbushin më shumë, në total kushtet e strehimit kanë 25 pikë zonja ka kapur vetëm 6 pikë, në lidhje me kushtet familjare nuk bën pjesë në asnjë nga grupet e vendosura në këtë kategori, në lidhje me kushtet sociale ka marë pike vetëm tek germa I persona me aftësi të kufizuar në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të këshillit të ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie këtu ka fituar 4 pikë, kemi dhe kushtet ekonomike dhe të ardhurat e kësaj familje rezultojnë në grupin e të ardhurave 70 deri në 100% të të ardhurave mesatare në total ka mbledhur 24 pikë dhe këto 24 pikë pavarësisht sistemit të pikëzimit që kemi aplikuar në këtë moment edhe sistemit të pikëzimit të tjera zonjën e ka bërë fituese, aplikimi i saj është për zgjerim unë e njoh historikun e banesave sociale sepse kam qënë pjesë e menaxhimit të saj dhe me vendim të këshillit bashkiak në vitin 2014 ka marrë strehim në ambientin 1 dhomë e 1 kuzhinë në katin e parë nën çati sepse ato objekte me atë arkitekturë janë dhe ka pasur në dispozicion 63 M2 nuk e di në ato momente është parë e arsyeshme strehimi në atë banesë sepse ka pasur ashensor dhe kjo e bënte shumë të lehtë, megjithatë duke parë gjendjen shëndetësore të djalit të saj, ankesat e shumta ne si komision strehimi unë kam qënë pjesë e komisionit të strehimit në atë kohë e kemi trajtuar përsëri në një apartament në katin e parë 1 dhomë e 1

kuzhinë sepse zonja këtë kërkonte që mos kishte ngjitje ose zbritje në katet e mësipërme, pra është marrë një vendim i këshillit bashkiak për ta lëvizur dhe kjo ka ndodhur në vitin 2021, në momentin që ne duke bërë rinovimin e kontratave në plotësim të detyrimeve ligjore që secili nga banorët atje duhet të vërtetojë që nuk ka banesë në pronësi u bë e mundur lirimi i dy apartamenteve 2 dhoma e 1 kuzhinë, këto 2 apartamente u hap thirrja erdhën 8 aplikime për të përfituar strehim atje dhe nga zyra është listuar sipas grumbullimit të pikëve të gjithë aplikantët, kanë qënë bashkëngjitur relacionit që zyra i paraqiti komisionit të strehimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Rabian të lutem mos ndërhy, ta kuptojmë dhe ne rastin tend, sepse kjo mënyrë sesi ndërhyti ti nuk po kuptojmë asgjë.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Të lutem të vazhdoj nëse ka interes nga këshilltarët, në detyrim të zbatimeve ligjore zyra ka për detyrë vetëm të listojë aplikimet që janë në plotësim të kushteve dhe atë ja paraqet komisionit këtë kemi bërë e ne kemi përgatitur dokumentacionin me të gjitha aplikimet dhe kemi thirrur komisionin e strehimit.

Këshilltar E.Bregu: Komisioni bën vlerësimin?

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Bën vlerësimin e listës që kemi përgatitur ne për çdo rast sepse ne nuk fshihemi, në datën 11 tetor është thirrur komisioni i strehimit për të trajtuar tre çështje, para se ne ti sillnim në këshillin bashkiak dhe ka qënë subvencioni i qirasë për 2 familje, ka qënë shpërndarja e banesave sociale dhe subvencioni i interesave të kredisë dhe nëqoftëse e vutë re processverbalin tek të gjitha çështjet është ndaluar për një kohë të konsiderueshme por më tepër tek banesat sociale, komisioni e pa të arsyeshme pasi vlerësoi të gjitha rastet për të cilën ne përgatitëm relacionit dhe ja sollëm këshillit bashkiak në datën 26 tetor 2023, të gjithë këshilltarët kanë qënë në dijeni dhe kemi diskutuar bashkë, nuk e di e lexuat proceverbalin apo jo por gjykimi i komisionit ka qënë ky që kjo familje me kushtet që ka dhe me lëvizjen që i është bërë në momentin që ne do kemi një apartament që shkon paralel me gjendjen që ka familja do trajtohet përsëri zonja nuk është jashtë, nuk është në kushtet e një mungese për strehim dhe me dëshirën e saj ka pranuar të shkoj tek ai apartament që ajo vazhdon jeton.

Këshilltar E.Bregu: Më fal të të ndërpres pak sepse çështja që diskutohet ishte krahasimi i disa dosjeve ne historikun e kemi dëgjuar edhe më parë.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Në bazë të historikut është bërë dhe vlerësimi.

Këshilltar E.Bregu: Tani kjo zonja thotë që unë kam pikë më shumë se ata të tjerët por më janë dhënë më pak ju janë shtuar atyre a i janë hequr zonjës unë këtë nuk e di dhe bazuar në rregulloren e këshillit dhe në udhëzimi që ju ka lënë kryetari i bashkisë por edhe në respekt për ligjin për mos nxjerjen e të dhënave sensitive në publik këshilli i bashkisë ka të drejtë ti shikojë dosjet mbase nuk ka të drejtë ti marrë me vete por ti shikojë ka.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Patjetër ne e sjellim që tani por duhet të rruhen të dhënat, nisur nga ankesat e zonjës zyra ka bërë verifikim në vend, apartamenti në të cilën banon është në kushte të përshtatshme për banim dhe nuk ka absolutisht asnjë gjë nga pretendimet e saj,

mund të ngrini dhe ju një komision dhe ta verifikoni nëqoftëse dyshoni tek kjo që ju them unë them.

Këshilltar E.Bregu: Më fal mund të të ndërhy pak Mirela njëra faqe ku është hyrja e pallatit është me myk vërtet, por ajo mund të rregullohet nuk është problem aty, sa hyn në pallat faqja që bie nga shkallët ka myk e kam pare unë, çështja është tek zgjerimi.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Apartamentet që kemi në dispozicion ishin në katin e tretë mbi dyqane dhe në katin e katërt, kjo zonjë si do e përballonte në një apartament pa ashensor.

Këshilltar E.Bregu: I ndajmë njëherë çështjet nëse ska mundësi zgjerimi por i takon është njëra çështje, çështja që thotë ajo që e ka të papërshtatshëm është çështje tjetër. Po marrim çështjen që e ka të papërshtatshëm sepse ka myk çfarë thotë ligji në këtë rast duhet ta ndihmojmë apo jo?

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Këta banorë kanë një kontratë qeraje, është thjesht mënyra e shfrytëzimit të apartamentit si e shfrytëzojme, ai nuk është myk por kondesim sepse të gjitha janë dural dhe ajo kërkon kujdes në ajrosje, nëqoftëse mbahen të mbyllura krijohet kondesim dhe lyerjet tek muret.

Këshilltar E.Bregu: Kondesimi krijohet sepse faqja e jashtme e murit është e ftohtë, brenda ka ajër të ngrohtë dhe krijon kondesim, riparimin duhet ta bëjë vetë apo ne?

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Ajo faqe që pretendon se e ka me myk ta them unë sepse kam shkuar disa herë, tek ai mur është vendosur një dollap në të gjithë gjatësinë dhe nuk krijon ajrosje, në çdo banesë nëqoftëse nuk krijon ajrosje krijohet kondesim. Çdo difekt Brenda apartamentit është përgjegjësi e familjes që jeton.

Këshilltar E.Bregu: Tani kalojmë tek çështja tjetër i takon zgjerim apo jo?

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Jo nuk i takon zgjerim, ka sjellë një çertifikatë me tre anëtarë dhe bazuar tek vendimi për normat e strehimit dhe normat e strehimit trajtohen në këtë mënyrë për këtë familje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal që po ndërhy unë do propozoja që këshilltarët të vijnë të shikojnë dosjet meqënëse e nxorën si propozim vetë dhe mos u lodhni të thoni se çfarë çertifikata ka sjellë zonja dhe ti shikojnë me rradhë.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Ta mbaroj argumentin nuk i takon, në bazë të normave të strehimit kjo familje përbëhet nga tre anëtarë dhe normat e strehimit llogariten 20 M2 plus numrin e anëtarëve shumëzim 10 M2 shkon në 50 M2 në rastin e kësaj familje që kemi person me aftësi të kufizuar shtohen 10 M2 zonja jeton në kushtet e një apartamenti 59 M2 ka qënë në 63 M2 dhe ka zbritur poshtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit drejtoresha, unë do sygjeroja këshilltarët e interesuar ta shikojnë dosjen vetë dhe më pas ta sqarojnë dhe zonjën, mire u takofshim mbledhjen e rradhës.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**

**ANA VERUSHI**





















































































































































































































































































































































































































































































































































































































































































































































